# INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SH.A.

Pasqyrat Financiare për periudhen deri me

31 Dhjetor 2011

(me raportin e audituesve te pavarur)

# PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Raporti i audituesve te pavarur | | 3 |
| Pasqyra e pozicionit financiar | | 4 |
| Pasqyra e te ardhurave | | 5 |
| Pasqyra e te ardhurave gjitheperfshirese | | 5 |
| Pasqyra e ndryshimeve ne kapital | | 6-7 |
| Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare | | 8-9 |
| Shenime shoqeruese mbi Pasqyrat Financiare | | 10 |
| 1. | Subjekti Raportues | 10 |
| 2. | Bazat e pergatitjes | 11 |
| 3. | Permbledhje e cmuarjeve dhe gjykimeve kontabel | 12 |
| 4. | Permbledhje e politikave kontabel | 13-27 |
| 5. | Menaxhimi i riskut financiar | 28-46 |
| 6. | Veprimtarite e Bankes ne deget e Shqiperise dhe Greqise | 47-50 |
| 7. | Vlera e drejte e instrumenteve financiare | 51-53 |
| 8 | Mjete monetare dhe te ngjashme | 54 |
| 9 | Hua dhe paradhenie bankave | 54 |
| 10. | Letra me vlere te vendosjes | 54 |
| 11. | Letra me vlere te investimit | 55 |
| 12. | Hua dhe paradhenie klienteve | 55-56 |
| 13. | Ndertesa dhe pajisje | 57-58 |
| 14. | Aktive afatgjata jomateriale | 59 |
| 15. | Mjete te tjera | 60 |
| 16. | Detyrime ndaj bankave | 61 |
| 17. | Detyrime ndaj klienteve | 62-63 |
| 18. | Borxhi i varur | 63 |
| 19. | Tatimi i shtyre | 64 |
| 20. | Provizione | 64-65 |
| 21. | Detyrime te tjera | 65 |
| 22. | Kapitali aksioner dhe primet | 66-67 |
| 23. | Rezerva ligjore dhe rregullative | 68 |
| 24. | Rezerva te tjera rivleresimi | 68 |
| 25. | Te ardhura nga interesi, neto | 69 |
| 26. | Te ardhura nga komisioni, neto | 70 |
| 27. | Te ardhura bankare nga tregtueshmeria, neto | 70 |
| 28. | Te ardhura / (shpenzime) te tjera operative, neto | 71 |
| 29. | Shpenzime personeli | 71 |
| 30. | Shpenzime te tjera | 71 |
| 31. | Shpenzime tatimi mbi fitimin | 72-73 |
| 32. | Angazhime dhe te drejta / detyrime te kushtezuara | 73-74 |
| 33. | Angazhime qeraje dhe shpenzime qeraje operacionale | 74 |
| 34. | Palet e lidhura | 75-76 |
| 35. | Ngjarje pas dates se bilancit | 76 |

Ernst & Young Certified Auditors
Sh.p.k .Skopje - Tirana Branch
Dibra Str "Observator Building"
7th Floor
Tirana, Albania

Tel: (+355 4) 2259 793
Fax: (+355 4) 2259 831
www.ey.com

# RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR PER AKSIONERET E BANKES INTESA SANPAOLO ALBANIA SH.A.

Ne kemi auditular pasqyrat financiare bashkëlidhur të Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a. të cilat përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2011, pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit, dhe pasqyrën e fluksit të parasë për ushtrimin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

## Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financial (SNRF), dhe për ato kontrolle të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimeve.

## Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është që, duke u bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne t'u përmbahemi kërkesave etike të përshtatshme, dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e proçedurave për të siguruar evidencë që mbështet tepricat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Proçedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit tonë, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, prej mashtrimit apo gabimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne shqyrtojme kontrollin e brendshëm i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e proçedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinioni për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit jep një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për opinionin tonë.

## Opinioni

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë për gjendjen financiare të Intesa Sanpaolo Bank Albania më datë 31 Dhjetor 2011, dhe për ecurinë financiare të saj, dhe flukset e parasë për ushtrimin e mbyllur, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Ernst & Young Certified Auditors Sh.p.k. Skopje – Dega Tiranë

Ernst + Young Certified Auditors Shpk

16 Mars 2012

# PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR ME 31 DHJETOR 2011

(NË '000 LEK)

| | Shenime | 2011 | 2010 |
|---|---|---|---|
| **AKTIVET** | | | |
| Mjete monetare dhe te ngjashme | 8 | 8,892,780 | 9,451,725 |
| Hua dhe paradhenie bankave | 9 | 16,530,111 | 10,498,496 |
| Letra me vlere te vendosjes | 10 | 1,865,935 | 2,668,123 |
| Letra me vlere te investimit | 11 | 51,572,399 | 49,641,226 |
| Hua dhe paradhenie klienteve | 12 | 47,432,286 | 45,753,791 |
| Ndertesa dhe pajisje | 13 | 1,530,969 | 1,656,909 |
| Aktive afatgjata jomateriale | 14 | 262,720 | 292,141 |
| Te drejta tatimore te shtyra | 19 | 42,079 | 40,572 |
| Te drejta tatimore korrente | | 157,221 | 264,968 |
| Mjete te tjera | 15 | 746,950 | 364,061 |
| **Aktive gjithsej** | | **129,033,450** | **120,632,012** |
| | | | |
| **DETYRIMET** | | | |
| Detyrime ndaj bankave | 16 | 5,370,471 | 1,650,859 |
| Detyrime ndaj klienteve | 17 | 107,197,718 | 104,604,212 |
| Llogari rrjedhese | | 27,990,307 | 29,473,190 |
| Depozita me afat | | 79,207,411 | 75,131,022 |
| Borxhi i varur | 18 | 534,334 | 532,568 |
| Detyrime tatimore korrente | | 58,242 | - |
| Detyrime tatimore te shtyra | 19 | - | 182,584 |
| Provizione | 20 | 318,601 | 217,269 |
| Detyrime te tjera | 21 | 995,005 | 732,014 |
| **Detyrime gjithsej** | | **114,474,371** | **107,919,506** |
| | | | |
| **KAPITALI AKSIONER** | | | |
| Kapitali i nenshkruar i paguar | 22 | 5,562,518 | 5,562,518 |
| Primet e aksioneve | 22 | 1,383,880 | 1,383,880 |
| Rezerva ligjore dhe rregullative | 23 | 3,348,267 | 1,752,404 |
| Rezerva per letrat me vlere te vendosjes | | (1,829,121) | (1,130,902) |
| Diferenca e rivleresimit nga kurset e kembimit | | 234,251 | 152,241 |
| Diferenca te tjera rivleresimi | 24 | 714,555 | 714,555 |
| Fitimi i pashperndare | | 5,144,729 | 4,277,810 |
| **Totali i Kapitalit Aksioner** | | **14,559,079** | **12,712,506** |
| **Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit Aksioner** | | **129,033,450** | **120,632,012** |

Shenimet nga faqja 10 deri ne 76 jane pjese integrale e pasqyrave financiare.

**Stefano Farabbi**
Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv

**Adela Xhemali**
Drejtore, Divizioni i Planifikimit dhe Kontrollit Financiar

# PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE ME 31 DHJETOR 2011

(në ’000 Lek)

| | Shenime | 2011 | 2010 |
|---|---|---|---|
| Te ardhura nga interesat | | 8,168,581 | 8,215,639 |
| Shpenzime per interesat | | (3,211,788) | (3,318,184) |
| **Te ardhura nga interesi, neto** | 25 | **4,956,793** | **4,897,455** |
| Te ardhura nga komisionet | | 764,348 | 725,360 |
| Shpenzime per komisionet | | (178,331) | (157,187) |
| **Te ardhura nga komisionet, neto** | 26 | **586,017** | **568,173** |
| Te ardhura bankare nga tregtueshmeria, neto | 27 | 346,295 | 355,584 |
| Te ardhura / (shpenzime) te tjera operative, neto | 28 | (216,248) | (224,921) |
| **Te ardhura operative** | | **5,672,857** | **5,596,291** |
| Humbje nga zhvleresimi i mjeteve financiare, neto | 12 | (1,001,917) | (993,626) |
| Shpenzime personeli | 29 | (931,551) | (1,086,711) |
| Shpenzime qeraje operacionale | 33 | (159,739) | (187,371) |
| Zhvleresimi dhe amortizimi | 13,14 | (335,953) | (342,923) |
| Amortizimi i permiresimeve te ambienteve me qira | 15 | (32,219) | (111,603) |
| Shpenzime te tjera administrative | 30 | (576,047) | (664,247) |
| Provizione per rreziqe dhe shpenzime | 20 | (90,327) | (41,401) |
| **Totali i shpenzimeve** | | **(3,127,753)** | **(3,427,882)** |
| **Fitimi neto para tatimit** | | **2,545,104** | **2,168,409** |
| Tatimi mbi fitimin | 31 | (77,838) | (252,885) |
| **Fitimi per periudhen** | | **2,467,266** | **1,915,524** |

| | Shenime | 2011 | 2010 |
|---|---|---|---|
| **Fitimi per periudhen** | | **2,467,266** | **1,915,524** |
| **Te ardhura te tjera gjitheperfshirese** | | | |
| Ndryshimi neto ne vleren e drejte te letrave me vlere te vendosjes | 24 | (698,219) | (241,593) |
| Efekti i tatimit mbi fitimin | | 69,822 | 24,159 |
| **Te ardhura te tjera gjitheperfshirese per periudhen, neto** | | **(628,397)** | **(217,434)** |
| **Totali i te ardhurave te tjera gjitheperfshirese per periudhen, neto** | | **1,838,869** | **1,698,090** |

Shenimet nga faqa 10 deri ne 76 jane pjese integrale e pasqyrave financiare.

**Stefano Farabbi**
Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv

**Adela Xhemali**
Drejtore, Divizioni i Planifikimit dhe Kontrollit Financiar

# PASQYRA FINANCIARE E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL DERI ME 31 DHJETOR 2011

(ne '000 Lek)

| | Kapitali i paguar | Primet e aksioneve | Rezervat | | Rezervat e vleresimit | | | Fitimi i vitit | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Fitimi i pashperndare | Rezerva statutore, te pergjithshme dhe ligjore | Rezerva per letrat me vlere te vendosjes | Rezerve e rivleresimit nga kurset e kembimit | Zëri gjithpërfshirës (Shënimi 24) | | |
| **Gjendja me 1 Janar 2010** | **5,562,518** | **1,383,880** | **1,146,965** | **1,347,176** | **(889,309)** | **106,952** | **714,555** | **1,618,221** | **10,990,958** |
| Transferimi i fitimit vjetor | - | - | 1,618,221 | - | - | - | - | (1,618,221) | - |
| Kalimi i fitimit te mbartur | - | - | (396,822) | 396,822 | - | - | - | - | - |
| Te ardhura te tjera gjitheperfshirese (Ndryshimi ne vleren e investimit ne letra me vlere te vendosjes, neto) | - | - | - | - | (241,593) | - | - | - | **(241,593)** |
| Diferenca valutore e rivleresimit | - | - | (6,078) | - | - | 53,695 | - | - | **47,617** |
| Riklasifikimi i rezervës ligjore | - | - | - | 8,406 | - | (8,406) | - | - | **-** |
| Fitimi i vitit | - | - | - | - | - | - | - | 1,915,524 | **1,915,524** |
| **Gjendja me 31 Dhjetor 2010** | **5,562,518** | **1,383,880** | **2,362,286** | **1,752,404** | **(1,130,902)** | **152,241** | **714,555** | **1,915,524** | **12,712,506** |

## PASQYRA FINANCIARE E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL DERI ME 31 DHJETOR 2011
(NE '000 LEK)

| | Kapitali i paguar | Primet e aksioneve | Rezervat | | Rezervat e vleresimit | | | Fitimi i vitit | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Fitimi i pashperndare** | **Rezerva statutore, te pergjithshme dhe ligjore** | **Rezerva per letrat me vlere te vendosjes** | **Rezerve e rivleresimit nga kurset e kembimi** | **Zëri gjithpërfshirës (Shënimi24)** | | |
| **Gjendja me 1 Janar 2011** | **5,562,518** | **1,383,880** | **2,362,286** | **1,752,404** | **(1,130,902)** | **152,241** | **714,555** | **1,915,524** | **12,712,506** |
| Transferimi i fitimit vjetor | - | - | 1,915,524 | - | - | - | - | (1,915,524) | **-** |
| Kalimi i fitimit te mbartur | - | - | (1,595,863) | 1,595,863 | - | - | - | - | **-** |
| Te ardhura te tjera gjitheperfshirese (Ndryshimi ne vleren e investimit ne letra me vlere te vendosjes, neto) | - | - | - | - | (698,219) | - | - | - | **(698,219)** |
| Diferenca valutore e rivleresimit | - | - | (4,484) | - | - | 82,010 | - | - | **77,526** |
| Riklasifikimi i rezerves ligjore | - | - | - | - | - | - | - | - | **-** |
| Fitimi i vitit | - | - | - | - | - | - | - | 2,467,266 | **2,467,266** |
| **Gjendja me 31 Dhjetor 2011** | **5,562,518** | **1,383,880** | **2,677,463** | **3,348,267** | **(1,829,121)** | **234,251** | **714,555** | **2,467,266** | **14,559,079** |

Shenimet nga faqa 10 deri ne 76 jane pjese integrale e pasqyrave financiare .

**Stefano Farabbi**
Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv

**Adela Xhemali**
Drejtore, Divizioni i Planifikimit dhe Kontrollit Financiar

# PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE DERI ME 31 DHJETOR 2011 (ne '000 Lek)

| | 2011 | 2010 |
|---|---|---|
| **Fluksi i parase nga/(ne) aktivitetet operative** | | |
| Fitimi i periudhës | **2,467,266** | **1,915,524** |
| Zerat qe rakordojne fitimin para tatimit me mjetet monetare neto te perdorura ne aktivitetet operacionale | | |
| Zhvleresimi i ndertesave dhe pajisjeve | 97,803 | 38,128 |
| Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale | 59,698 | 106,556 |
| Zhvleresimi i permiresimeve te ambjenteve me qira | 32,219 | 111,603 |
| Shitja e aktiveve afatgjata jomateriale | 59,950 | - |
| Shitja e ndertesave dhe pajisjeve | 118,502 | 198,239 |
| Amortizimi i investimeve ne letra me vlere te mbajtura deri ne maturim- bono thesari | (79,672) | 162,687 |
| Amortizimi i investimeve ne letra me vlere te mbajtura deri ne maturim- te ndryshme nga bono thesari | 78,284 | (25,806) |
| Amortizimi i letrave me vlere te vendosjes | 6,273 | 3,556 |
| Humbje nga zhvleresimi i mjeteve financiare | 1,001,917 | 993,626 |
| Rritje (pakesim) ne interesin per t'u arketuar | (134,406) | (60,274) |
| Pakesim (rritje) ne interesin per t'u paguar | (54,420) | (25,335) |
| Diferenca nga ndryshimi i kursit te kembimit | 77,791 | 69,140 |
| **Ndryshime ne aktive dhe detyrime operative** | | |
| Ndryshime ne hua dhe paradhenie bankave | (5,981,007) | (1,803,696) |
| Ndryshime ne hua dhe paradhenie klienteve | (2,596,612) | 795,257 |
| Ndryshime ne aktive te tjera | (415,110) | (41,919) |
| Ndryshime ne aktive tatimore te shtyra | (1,507) | (894) |
| Ndryshime ne detyrime ndaj bankave | 3,720,646 | (2,909,352) |
| Ndryshime ne detyrime ndaj klienteve | 2,648,051 | 7,207,558 |
| Ndryshime ne detyrime te tjera dhe provizione | 364,321 | 150,704 |
| Ndryshime ne detyrime tatimore te shtyra | (182,584) | 140,397 |
| Ndryshime ne tatime korrente | 165,989 | (127,605) |
| **Fluksi neto i parase nga aktivitetet operative** | **(1,013,874)** | **4,982,570** |
| **Fluksi i parase nga aktivitetet investuese** | | |
| Shitja (blerja) e aktiveve afatgjata jomateriale | (90,272) | (107,346) |
| Shitja (blerja) e ndertesave dhe pajisjeve | (90,584) | (53,497) |
| Shitja (blerja) e investimeve financiare | (1,832,089) | (3,031,249) |
| **Fluksi neto i parase nga aktivitetet investuese** | **(2,012,945)** | **(3,192,092)** |

# PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE DERI ME 31 DHJETOR 2011 (në '000 Lek)

| | 2011 | 2010 |
|---|---|---|
| **Rrjedhja neto e parase nga aktivitetet financuese** | | |
| Rritje (pakesim) i borxhit te varur | 608 | 3,078 |
| **Fluksi neto i parase nga aktivitetet financuese** | **608** | **3,078** |
| **Ndryshimi (Rritja/Rënia) i mjeteve monetare gjate periudhes** | **(558,945)** | **3,709,080** |
| Mjete monetare e te ngjashme ne fillim te periudhes | 9,451,725 | 5,742,645 |
| **Mjete monetare e te ngjashme ne fund te periudhes** | **8,892,780** | **9,451,725** |
| | | |
| **Fluksi i parase operative nga interesat:** | | |
| Interesa te paguara | 3,264,143 | 3,354,508 |
| Interesa te arketuara | 8,039,060 | 8,295,802 |

Gjate vitit 2011, Banka pagoi tatim fitimi per vitin aktual nje shume totale prej Lek 261,928 mije (2010: Lek 161,841 mije).

Shenimet nga faqja 10 deri ne 76 jane pjese integrale e pasqyrave financiare.

Keto pasqyra financiare jane miratuar nga Keshilli Drejtues i Bankes ne 2 Mars 2012.

Pas nxjerrjes se tyre, çdo ndryshim eshte kompetence e Aksionereve te Bankes. Pasqyrat financiare jane firmosur ne emer te Bankes nga:

**Stefano Farabbi**
Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv

**Adela Xhemali**
Drejtore, Divizioni i Planifikimit dhe Kontrollit Financiar

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 1. SUBJEKTI RAPORTUES

Intesa Sanpaolo Bank Albania, (me poshte referuar "Banka"), themeluar ne Maj te vitit 1998, u autorizua qe te ushtronte aktivitet bankar ne Shqiperi ne perputhje me ligjin nr. 8365, "Per Sistemin Bankar ne Shqiperi", datë 2 Korrik 1998, i cili u zevendesua nga ligji nr. 9662 "Per Bankat ne Shqiperi", date 18 Dhjetor 2006, i cili hyri ne fuqi ne Qershor 2007. Banka e filloi aktivitetin e vet me 24 Shtator 1998.
Me 20-21 Dhjetor 2006, Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve (me poshte referuar "FSHAN") ne cilesine e tij si aksioneri i vetem i Bankes, firmosi nje marreveshje per Shitblerjen e Aksioneve (me poshte referuar "Marreveshja e Blerjes") me SANPAOLO IMI S.p.A ("Bleresi"), nje kompani e themeluar ne perputhje me Ligjet e Republikes Italiane, me synimin e shitjes te 12,000,000 aksioneve te Bankes me nje vlere nominale prej 2.2266 USD qe perbente rreth 80% te vleres totale te kapitalit te Bankes, kundrejt nje çmimi prej 125,520 mije USD ("Çmimi i Blerjes"). Me 1 Janar 2007, SANPAOLO IMI S.p.A dhe Banca Intesa S.p.A krijuan Intesa Sanpaolo S.p.A nepermjet bashkimit te te dy bankave. Ne 29 Qershor 2007, Data e Mbylljes e percaktuar ne Marreveshjen e Blerjes, pas plotesimit te te gjitha kushteve, perfaqesuesit e FSHAN dhe te Intesa Sanpaolo S.p.A nenshkruan transferimin e aksioneve.

Banka dhe Banka Italo Albanese Sh.a. (e njohur si Banka Italo Shqiptare ose BIA) u bashkuan nepermjet perthithjes se aktiveve dhe pasiveve te BIA ne aktivitetet e Intesa Sanpaolo Bank Albania. Te gjithe aksioneret miratuan termat dhe kushtet e bashkimit, sipas Planit te Bashkimit dhe Marreveshjes per Bashkim ne daten 6 Nentor 2007 dhe Shtojces date 4 Dhjetor 2007. Kursi i kembimit te aksioneve u percaktua sipas metodologjise per vleren kontabel te rregulluar neto (vlera e rregulluar e aktivit) ne baze te pjesemarrjes se aksionereve dhe vleresimit perkates te situates financiare te seciles Banke me 30 Qershor 2007, si nje perqindje e vleresimit te kombinuar te te dy bankave ne te njeten date, pavaresisht numrit te aksioneve qe do te regjistroheshin.
Ne daten 4 Gusht 2009, Intesa Sanpaolo S.p.A ("Bleresi") ne cilesine e aksionerit kryesor te Bankes, nenshkroi nje Marreveshje per Shitblerjen e Aksioneve me Fondin Shqiptaro – Amerikan te Ndermarrjeve, per transferimin e pronesise se 1,751,283 aksioneve dhe ne daten 14 Gusht 2009 te dyja palet nenshkruan Deklaraten Perfundimtare ku pranonin permbushjen e kushteve kontraktuale, duke perfunduar kete transaksion. Detaje te pjesemarrjes se Aksionereve paraqiten ne Shenimin 22.

Banka, me seli ne Tirane, ne adresen Rruga "Ismail Qemali", nr.27, operon nepermjet nje rrjeti te perbere nga 31 dege dhe agjensi ne qytete te ndryshme te Shqiperise: Tirane, Durres, Vlore, Elbasan, Fier, Gjirokaster, Korçe, Lushnje, etj, (2010: 31 dege dhe agjensi).

Ne 31 Dhjetor 2011 Banka numeronte 547 punonjes (2010: 543).

Pas marrjes se miratimit perfundimtar te Bankes se Shqiperise, duke filluar nga data 13 Tetor 2008 emri i Bankes u ndryshua nga Banka Amerikane e Shqiperise ne Intesa Sanpaolo Bank Albania.

Pasqyrat financiare te Bankes deri me 31 Dhjetor 2011 dhe per periudhen ushtrimore te mbyllur, perfshijne gjithashtu degen ne Greqi, e cila operon si subjekt fiskal me vete. Veprimtaria e degës në Greqi u mbyll në datën 16 Korrik 2011.

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 2. BAZAT E PERGATITJES

### (a) Deklarate per perputhshmerine rregullative

Ne perputhje me legjislacionin kontabel vendas, pasqyrat financiare jane pergatitur sipas Standarteve Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) te vendosura nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (BSNK).

### (b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me parimin e kostos historike, duke bere perjashtim vetem per mjetet finaciare te letrave me vlere te vendosjes, te cilat jane te matura me vleren e drejte.

### (c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare jane te raportuara ne Lek, e cila eshte ne te njejten kohe edhe monedha funksionale e Bankes.

Diferencat e konvertimit perfshijne te gjitha diferencat nga kurset e kembimit si pasoje e konvertimit te pasqyrave financiare te veprimtarise se filialit te huaj ne monedhen funksionale dhe raportuese te Bankes. Monedha funksionale e deges se Greqise ishte Euro.

Me perjashtim te rasteve kur eshte specifikisht e shprehur, informacioni financiar i shprehur ne Lek eshte rrumbullakosur ne te mijten me te afert.

### (d) Bazat e konsolidimit

Pasqyrat financiare perfshijne pasqyrat financiare te Bankes dhe deges se saj per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor.

*(i) Filialet*

Filialet jane entitete te cilat jane te kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka ka te drejte te vendose politikat financiare dhe operative te nje entiteti ne menyre qe te siguroje perfitime prej ushtrimit te aktivitetit te tij. Gjate vleresimit te kontrollit, te drejtat e votes qe ushtrohen aktualisht, jane marre ne konsiderate. Pasqyrat financiare te filialeve jane te perfshira ne pasqyrat financiare qe nga data e fillimit te ushtrimit te kontrollit deri ne daten qe ky kontroll merr fund.

*(ii) Transaksionet e eliminuara gjate konsolidimit*

Tepricat qe rrjedhin nga marredheniet brenda grupit, dhe te ardhurat e shpenzimet e parealizuara qe burojne nga transaksione brenda grupit, jane eliminuar ne momentin qe jane pergatitur pasqyrat financiare.Te ardhurat e parealizuara jane eliminuar ne pergatitjen e pasqyrave financiare. Shpenzimet e parealizuara jane eliminuar ne te njejten menyre si te ardhurat e parealizuara, por vetem ne ate mase kur nuk ka tregues per zhvleresim.

*(iii) Bashkimi me entitete nen te njejtin kontroll*

Bashkimi me perthithje i Bankes me BIA u kontabilizua me 1 Janar 2008, sipas percaktimit ne marreveshjen e bashkimit. Aktivet dhe detyrimet e marra jane njohur ne shumat e mbartura, te njohur me pare ne pasqyrat financiare te grupit te aksionereve nen kontrollin e tyre.

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 3. PERDORIMI I ÇMUARJEVE DHE GJYKIMEVE KONTABEL

Gjate proçesit te zbatimit te politikave kontabel te Bankes, drejtimi ka perdorur gjykimet dhe çmuarjet ne percaktimin e shumave qe njihen ne pasqyrat financiare. Perdorimet me te rendesishme te gjykimeve dhe çmuarjeve jane si me poshte:

### (a) Vijimesia

Drejtimi i Bankes ka vleresuar mundesine e Bankes per te vazhduar ne vijimesi dhe eshte i kenaqur qe banka ka burime per te vazhduar biznesin dhe aktivitetin ne te ardhmen. Gjithashtu Drejtimi nuk eshte ne dijeni te ndonje pasigurie materiale te cilat mund te sjellin dyshime mbi mundesine e Bankes per te vazhduar ne vijimesi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojne te pergatiten ne baze te vijimesise.

### (b) Vlera e drejte e instrumenteve financiare

Ne rastet kur vlera e drejte e aktiveve dhe detyrimeve financiare, e regjistruar ne pasqyren e gjendjes financiare, nuk mund te perfitohet nga tregjet aktive, ato percaktohen duke perdorur disa teknika te ndryshme vleresimi te cilat perfshijne dhe perdorimin e modeleve matematikore. Te dhenat qe perdoren ne keto modele jane te dhenat qe vezhgohen ne treg, dhe kur keto te dhena nuk jane te disponueshme, nepermjet gjykimit percaktohen vlerat e drejta. Per instrumentet financiare qe nuk tregtohen shpesh dhe kane transparence te kufizuar per çmimin, vlera e drejte eshte me pak objektive dhe nevojiten nivele te ndryshme gjykimi ne varesi te likuiditetit, perqendrimit, pasigurise se faktoreve te tregut, supozime çmimi dhe risqe te tjera qe prekin instrumentin e caktuar. Vleresimi i instrumenteve financiare paraqitet ne menyre te detajuar ne Shenimin 7.

### (c) Humbjet nga zhvleresimet per huate dhe paradheniet

Banka rishikon dhe analizon huate dhe paradheniet individuale te rendesishme ne çdo date te hartimit te pasqyres se gjendjes financiare per te vleresuar nese humbjet nga zhvleresimi duhet te regjistrohen ne pasqyren e te ardhurave. Ne menyre te veçante, gjykimi nga drejtimi eshte i nevojshem per vleresimin e shumes dhe kohen e rrjedhjes se ardhshme te parase kur percaktohen humbjet nga zhvleresimi. Ne perllogaritjen e fluksit te parase, banka gjykon situaten financiare te huamarresit dhe vleren neto te realizueshme te kolateralit. Keto çmuarje bazohen ne supozime lidhur me disa faktore dhe rezultatet aktuale mund te ndryshojne, duke sjelle ndryshime te ardhshme ne zbritjet nga huate.

Huate dhe paradheniet e vleresuara ne menyre individuale dhe rezultuar te pazhvleresueshme, si dhe te gjitha huate dhe paradheniet individuale jo te konsiderueshme vleresohen kolektivisht, ne grupe aktivesh me karakteristika te ngjashme risku, per te percaktuar nese duhen krijuar provigjione per shkak te ngjarjeve te humbjeve per te cilat ekziston prove evidente, por efektet ende nuk jane te dukshme. Vleresimi kolektiv merr ne konsiderate te dhenat nga portofoli i huave (si cilesia e kredise, ditet e vonesave, perdorimi i kredise, etj) dhe perqendrimet e tjera te riskut dhe te dhenave ekonomike.

Humbjet nga zhvleresimi per huate dhe paradheniet paraqiten ne menyre te detajuar ne Shenimin 12.

### (d) Te drejta tatimore te shtyra

Te drejtat tatimore te shtyra te cilat rezultojnë nga humbjet nga tatimet njihen si aktive nese ekzistojne gjasat qe fitimi i tatueshem ne te ardhmen do te jete i mjaftueshem per te lejuar fitimin nga humbjet qe do te realizohen. Gjykimi eshte i nevojshem per te percaktuar shumen e te drejtave te tatimit te shtyre qe mund te njihet, ne baze te kohes dhe nivelit te ardhshem te fitimit te tatueshem dhe strategjive te ardhshme te planifikimit tatimor. Per me shume detaje referojuni Shenimit 4 (g).

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL

Politikat kontabel te percaktuara me poshte jane aplikuar ne menyre te vazhdueshme per te gjithe periudhen e pasqyrave financiare si dhe jane aplikuar vazhdimisht nga njesite e Bankes.

### (a) Monedha e huaj

*(i) Transaksionet ne monedhe te huaj*

Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar fillimisht ne monedhen funksionale te Bankes me kursin e kembimit te dates se transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare ne valute te huaj jane rikonvertuar ne monedhen funksionale me kurset e kembimit ne daten e mbylljes se bilancit. Te gjitha diferencat respektive si pasoje e kesaj te fundit, kalojne ne pasqyren e te ardhurave, perveç diferencave qe vijne nga rivleresimi i kapitalit te nenshkruar e te paguar, te cilat transferohen menjehere ne nje rezerve te posaçme te kapitalit.

Aktivet dhe detyrimet jo-monetare ne valute te huaj te matura me vleren e drejte, jane ri-konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se percaktimit te vleres se drejte. Diferencat e konvertimit te cilat rezultojne nga rikonvertimet njihen ne llogarine fitim- humbje.

*(ii) Operacionet e huaja*

Mjetet dhe detyrimet nga operacionet e huaja jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit. Te ardhurat e shpenzimet nga operacionet e huaja jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e transaksionit.

Diferencat e konvertimit njihen direkt ne kapital. Nga data 1 Janar 2007, data e kalimit te raportimit te Bankes sipas SNRF, keto diferenca jane pasqyruar ne rezerven per diferencen valutore te rivleresimit. Nese nje operacion i huaj mbyllet pjeserisht ose plotesisht, shuma perkatese e diferences valutore te rivleresimit transferohet ne llogarine fitim humbje.

### (b) Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

Te ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen ne pasqyren e te ardhurave me ane te metodes se normes efektive te interesit. Norma efektive e interesit eshte norma e cila ben aktualizimin e flukseve te pagesave dhe arketimeve te pritshme ne te ardhmen gjate kohezgjatjes se pritshme te aktivit ose detyrimit financiar (ose mund te jete nje periudhe me e shkurter) deri ne shumen e mbartur te aktivit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit percaktohet me njohjen fillestare te aktivit dhe detyrimit financiar dhe nuk rishikohet me pas. Llogaritja e normes efektive te interesit perfshin te gjitha komisionet e paguara ose te arketuara, shpenzimet per transaksionet, dhe zbritjet ose primet qe jane pjese e normes efektive te interesit. Shpenzimet e transaksionit jane shpenzime shtese qe i atribuohen ne menyre direkte blerjes, emetimit ose shitjes se nje aktivi ose detyrimi financiar.

### (c) Te ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet

Te ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet qe jane pjese integrale e normes efektive te interesit te nje aktivi ose detyrimi financiar perfshihen ne percaktimin e normes efektive te interesit.

Te ardhurat e tjera nga komisionet, perfshire komisionet e sherbimit, komisionet per menaxhim investimi, komisionet per shitje dhe vendosje depozite njihen ne momentin e kryerjes se sherbimeve.

Shpenzime te tjera nga komisionet lidhen kryesisht me komisionet per transaksione dhe sherbime, te cilat kalojne ne shpenzime ne momentin e marrjes se sherbimit te ofruar

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### (d) Te ardhura bankare nga tregtueshmeria, neto

Keto te ardhura perfshijne fitimin minus humbjet qe rezultojne nga tregtimi i aktiveve dhe detyrimeve, dhe perfshijne te gjitha ndryshimet e vleres se drejte dhe diferencat e kembimeve valutore.

### (e) Te ardhura nga dividentet

Te ardhurat nga dividentet njihen kur vendoset e drejta per te perfituar te ardhura. Zakonisht, kjo behet ne daten e ish-dividentit per letrat me vlere te kapitalit. Dividentet pasqyrohen si komponent i te ardhurave bankare neto nga tregtueshmeria, te ardhurave neto nga instrumente te tjera financiare te matura me vleren e drejte ose te ardhurave te tjera operative, ne baze te klasifikimit te instrumentit te kapitalit.

### (f) Qeraja dhe permiresimet e ambjenteve me qera – Banka si qeramarrese

Percaktimi nese nje marreveshje eshte kontrate qiraje ose permban nje te tille, bazohet ne thelbin dhe permbajtjen e marreveshjes dhe kerkon nje vleresim te faktit nese permbushja e detyrimeve te marreveshjes varet nga perdorimi i nje aktivi ose aktiveve te veçante dhe nese ne marreveshje parashikohet e drejta per perdorimin e aktivit.

Banka ka vetem marreveshje qeraje operacionale, pagesat e te cilave njihen ne pasqyren e te ardhurave me metoden lineare gjate gjithe kohezgjatjes se qerase. Shpenzimet per permiresimin e ambjenteve qe perdoren ne baze te ketyre marreveshjeve kontabilizohen si mjete te tjera dhe amortizohen linearisht pergjate kohezgjatjes se qerase.

Pagesat rastesore per qerate kontabilizohen me ane te rishikimit te pagesave minimale te qerase per periudhen e mbetur ne momentin e konfirmimit te ndryshimit te kontrates se qerase.

### (g) Tatimi mbi fitimin

Te drejtat apo detyrimet aktuale tatimore per vitin aktual dhe ata te meparshem llogariten ne ate vlere qe pritet per t'u marre ose paguar autoriteteve tatimore. Normat e taksave dhe ligjet ne lidhje me to te perdorura per llogaritjen e vleres se detyrimit tatimor jane ato qe ndodhen ne fuqi apo qe jane pothuajse efektive ne daten e bilancit.

Tatimi i shtyre gjendet mbi diferencat e perkohshme ne daten e bilancit ndermjet bazes se taksueshme te aktiveve dhe detyrimeve dhe vleres se tyre te mbartur per qellime raportimi financiar. Detyrime te shtyra tatimore njihen per te gjitha diferencat e perkohshme te tatueshme, perveç:

- kur detyrimi i shtyre tatimor vjen si pasoje e njohjes fillestare te nje te drejte apo detyrimi ne nje transaksion qe nuk eshte kombinim biznesi, dhe ne momentin e transaksionit, nuk ndikon as ne fitimin kontabel as ne fitimin apo humbjen e taksueshme; dhe
- ne lidhje me diferencat e perkohshme te taksueshme te lidhura me investimet ne filialet, ku koha e rikthimit te diferencave te perkohshme mund te kontrollohet dhe eshte e mundshme qe diferencat e perkohshme te mos kthehen ne nje te ardhme te parashikueshme (te afert).

## SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

# 4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### (g) Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

E drejta tatimore e shtyre njihet per te gjitha diferencat e perkohshme te zbritshme, deri ne ate nivel ku eshte e mundshme qe fitimi i tatueshem te materializohet, kundrejt te cilit diferencat e perkohshme te zbritshme mund te perdoren, perveç:

- nese te drejtat tatimore te shtyra te lidhura me diferencat e perkohshme te zbritshme vijne si pasoje e njohjes fillestare te nje aktivi apo detyrimi ne nje transaksion qe nuk eshte kombinim biznesi, dhe qe ne momentin e transaksionit, nuk ndikon as ne fitimin kontabel as ne fitimin apo humbjen e tatueshme; dhe
- ne lidhje me diferencat e perkohshme te zbritshme qe i atribuohen investimeve ne filiale, te drejtat e shtyra tatimore jane njohur deri ne ate nivel ku eshte e mundshme qe diferencat e perkohshme do te kthehen ne nje te ardhme te afert dhe fitimi i tatueshem do te jete materializuar kundrejt te cilit diferencat e perkohshme mund te perdoren.

Vlera e mbartur e te drejtave tatimore te shtyra rishikohet ne çdo date bilanci dhe reduktohet deri ne ate nivel qe nuk eshte me e mundshme qe nje fitim i mjaftueshem dhe i tatueshem do te materializohet per te lejuar qe e gjitha apo nje pjese e te drejtave tatimore te shtyra te perdoren. Te drejtat tatimore te shtyra te panjohura rivleresohen ne çdo date bilanci dhe njihen deri ne ate nivel qe eshte e mundshme qe fitimi i ardhshem i tatueshem do te mundesoje qe te drejtat tatimore te shtyra te rimerren.

Te drejtat dhe detyrimet e shtyra tatimore maten me normat e taksave qe priten te zbatohen ne vitin ne te cilin nje e drejte krijohet apo nje detyrim shlyhet, i bazuar ne normat e taksave (dhe ligjet per to) te fuqizuara apo pothuajse te fuqizuara ne daten e bilancit.

Tatimi aktual apo i shtyre qe lidhet me zera, te cilet njihen menjehere ne kapital, njihen gjithashtu ne nje rezerve ne kapital dhe jo ne pasqyren e te ardhurave.

Te drejtat dhe detyrimet e shtyra tatimore kompensohen me njera-tjetren, nese nje e drejte e detyrueshme ligjore ekziston per te kompensuar nje te drejte tatimore aktuale kundrejt nje detyrimi tatimor aktual dhe tatimet e shtyra lidhen me te njejtet subjekte te tatueshem dhe autoritet tatimor.

### (h) Aktivet dhe detyrimet financiare

*(i) Njohja*

Banka fillimisht njeh huate dhe paradheniet, depozitat dhe huamarrjet ne daten kur ato jane krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta te aktiveve financiare njihen ne daten e tregtimit kur banka angazhohet per blerjen ose shitjen e aktivit. Te gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht ne daten e tregtimit ne te cilen Banka behet pale per respektimin e dispozitave kontraktuale te instrumentit.

*(ii) Klasifikimi*

Shikoni politikat kontabel 4 (i) (j) (k) dhe (l).

*(iii) Mos-njohja*

Banka nuk e njeh me nje aktiv financiar nese te drejtat kontraktuale per perfitimin e parave nga aktivi jane shuar, ose nese transferohen te drejtat per te marre perfitimin kontraktual nga aktivi financiar ne nje transaksion nepermjet te cilit transferohen te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesise mbi aktivin financiar. Çdo interes ne aktivet financiare te transferuara qe krijohet ose mbahet nga Banka njihet si nje aktiv ose detyrim me vete. Banka nuk njeh nje detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale jane shfuqizuar, anulluar ose kur u skadon afati.

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### (h) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

*(iii) Mos-njohja (vazhdim)*

Banka kryen transaksione nepermjet te cilave transferon aktivet e njohura ne bilancin e saj kontabel, por mban te gjitha ose ne thelb te gjitha rreziqet dhe shperblimet e aktiveve te transferuara, apo ndonje pjese te tyre. Ne rast se Banka merr persiper te gjitha ose ne thelb te gjitha rreziqet dhe shperblimet aktuale ose te mevonshme, atehere aktivet e transferuara vazhdojne te njihen ne bilancin kontabel. Transferimi i aktiveve, nderkohe qe merren persiper te gjitha ose ne thelb te gjitha rreziqet dhe shperblimet aktuale ose te mevonshme perfshijne per shembull huadhenien e letrave me vlere dhe transaksionet e marreveshjeve te riblerjes.

Per transaksionet ku Banka nuk mban dhe as transferon ne menyre thelbesore te gjitha rreziqet dhe shperblimet aktuale ose te mevonshme qe rrjedhin nga pronesia mbi aktivin financiar, ajo nuk e njeh aktivin ne rast se nuk ka kontroll mbi aktivin. Te drejtat dhe detyrimet qe mbahen gjate transferimit njihen me vete si aktive dhe detyrime, sipas rastit. Ne transferime, ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon te njohe aktivin per aq kohe sa ky aktiv rezulton i perfshire, e cila percaktohet nga niveli i ekspozimit ndaj ndryshimeve ne vleren e aktivit te transferuar .

Banka fshin kredi te caktuara te cilat percaktohen si kredi te pakthyeshme (shih Shenimin 5).

Rimarrja e nje zeri te fshire nga bilanci regjistrohet nen zerin Te ardhura/shpenzime te tjera operative ne pasqyren e te ardhurave (shih Shenimin 28).

*(iv) Kompensimi*

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet ne bilancin kontabel kur dhe vetem kur Banka gezon te drejten ligjore per te bere kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qellim likuidimin mbi bazen neto ose likuidimin e aktivit dhe shlyerjen e detyrimit njekohesisht.

Te ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto vetem nese lejohen nga standardet e kontabilitetit, ose per fitime apo humbje te cilat rezultojne nga realizimi i transaksioneve te ngjashme ne aktivitetin tregtar te Bankes.

*(v) Matja me kosto te amortizuar*

Kosto e amortizuar e aktivit ose detyrimit financiar perben shumen me te cilen aktivi dhe detyrimi financiar matet ne fazen e njohjes fillestare, minus kthimin e principalit, plus ose minus vleren e amortizimit te akumuluar duke perdorur metoden e interesit efektiv per te gjitha ndryshimet midis shumes fillestare qe eshte njohur dhe shumes se maturuar, duke zbritur ndonje humbje nga zhvleresimi.

*(vi) Matja me vleren e drejte*

Percaktimi i vleres se drejte te aktiveve dhe detyrimeve financiare bazohet ne çmimet e kuotuara ne treg ose çmimet e kuotuara nga agjenti per instrumentet financiare te cilat tregtohen ne tregjet aktive. Per te gjitha instrumentat e tjere financiare vlera e drejte percaktohet me ane te teknikave te vleresimit. Teknikat e vleresimit perfshijne metoden e vleres aktuale neto, metoden e zbritjes se fluksit te mjeteve monetare, krahasimin me instrumente te ngjashme per te cilat ne treg ekzistojne çmimet perkatese, dhe modelet e vleresimit. Banka perdor modele vleresimi te njohura gjeresisht per percaktimin e vleres se drejte te instrumenteve financiare te zakonshme dhe te thjeshta si opsionet dhe kontratat "swap" te normave te interesit dhe kembimeve valutore. Per keto instrumente financiare informacionet qe perdoren ne modele jane te dukshme ne treg.

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### (h) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

*(vii) Identifikimi dhe matja e zhvleresimeve*

Ne çdo date te bilancit kontabel, Banka vlereson nese ekzistojne prova objektive qe aktivet financiare te cilat nuk jane mbajtur me vleren e drejte permes pasqyres se te ardhurave jane te zhvleresuara.

Aktivet financiare jane te zhvleresuara kur faktet objektive tregojne qe nje ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare te aktivit, dhe qe kjo ngjarje humbjeje ka nje impakt ne flukset e ardhshme te parase nga ky mjet qe mund te vleresohen ne menyre te besueshme.

Banka merr ne konsiderate treguesit per zhvleresimin e aktiveve ne nivelin e nje aktivi te vetem dhe kolektivisht. Te gjitha aktivet financiare te rendesishme vleresohen veçmas per zhvleresime specifike. Aktivet financiare te cilat nuk rezultojne te zhvleresuara ne veçanti, vleresohen te gjitha se bashku per ndonje zhvleresim qe mund t'i kete ndodhur, por qe nuk eshte identifikuar ende, duke grupuar se bashku aktivet financiare (te mbajtura me koston e amortizuar) te cilat paraqesin karakteristika te ngjashme te riskut.

Kriteret per klasifikimin dhe evidentimin objektiv per zhvleresimet jane te meposhtmet:

- Veshtiresi serioze financiare nga ana e huamarresit
- Shkelja e kontrates, p.sh. mospagesa apo vonesat ne pagesat e interesit dhe principalit te cilat shfaqen gjate tre muajve te fundit
- Ristrukturimi i kredive si pasoje e veshtiresive financiare te klientit
- Probabiliteti i falimentimit
- Te dhena te observueshme qe tregojne se ka nje renie te matshme te fluksit te parase nga nje grup aktivesh qe nga koha e njohjes se ketyre aktiveve
- Kushte ekonomike kombetare ose lokale qe lidhen ne menyre te drejtperdrejte me falimentimet ne aktivet e ketij grupi
- Per sa i perket menaxhimit te provizoneve, Banka mund te vendose mbi klasifikimin e ekspozimit duke u bazuar edhe mbi evidenca subjektive, ne menyre te pavarur nga kriteret e percaktuara me siper, duke aplikuar kritere te tjera jo gjeresisht te parashikuara te cilat mund te evidentohen ne disa raste individuale.

Vonesat te cilat jane me shume se 60 dite jane subjekt i nje vleresimi individual. Zhvleresimi matet si diferenca midis vleres neto te nje kredie dhe vleres aktuale te fluksit te parashikuar te parase, duke konsideruar qe fluksi i parase vjen nga vlera e realizueshme e kolateraleve dhe/ose garancite qe sigurojne keto ekspozime.

Te gjithe klientet qe kane linja huaje te ristrukturuara jane subjekt i testimeve per zhvleresim individual dhe mbeten pjese e ketyre vleresimeve per nje periudhe prej te pakten dy viteve nga data e ristrukturimit dhe/ose dates se riskedulimit, pavaresisht nga pagesat e kryera ne vazhdimesi te kushteve te reja te ripagimit.

Te gjitha huate per te cilat "nuk identifikohen prova objektive zhvleresimi" vleresohen ne menyre kolektive. Vleresimi kolektiv behet sipas grupeve te kredive me karakteristika te ngjashme risku, dhe duke marre ne konsiderate historikun e normave te mosrealizimit dhe perqindjeve perkatese per humbjet nga kredite, ne baze te elementeve te dukshem ne daten e bilancit. Vleresimi merr parasysh , gjithashtu, edhe riskun qe paraqet vendi i huamarresit.

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### (h) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

*(vii) Identifikimi dhe matja e zhvleresimeve (vazhdim)*

Humbjet nga zhvleresimi i aktiveve maten ne baze te diferences se shumes se mbartur te aktiveve financiare dhe vleres aktuale te fluksit te perllogaritur te mjeteve monetare te skontuar me normen fillestare efektive te interesit te aktiveve. Humbjet njihen tek pasqyra e te ardhurave dhe paraqiten ne llogarine e zbritjes se huave dhe paradhenieve. Kur nje ngjarje e mevonshme influencon ne zvogelimin e shumes se humbjes nga zhvleresimi i aktivit, humbja kthehet tek pasqyra e te ardhurave.

Aty ku eshte e mundur Banka ben ristrukturimin/rinegocimin e huave sesa marrjen ne zoterim te kolateralit. Kjo perfshin zgjatjen e afatit te pagesave per kthimin e huase dhe marreveshje per kushte te reja kredie. Menjehere pas rinegocimit te kushteve zhvleresimi matet ne baze te normes efektive te interesit fillestar siç eshte llogaritur perpara ndryshimit dhe modifikimit te kushteve dhe huaja nuk konsiderohet me me vonesa. Drejtimi ne menyre te vazhdueshme rishikon kredite e rinegociuara per te garantuar permbushjen e te gjitha kritereve dhe kryerjen e pagesave ne te ardhmen.

### (i) Mjete monetare dhe te ngjashme

Mjete monetare dhe te ngjashme perfshijne mjetet ne arke, gjendjet e pakufizuara me bankat qendrore dhe depozitat afat shkurtra shume likuide me maturitet me pak se 3 muaj, te cilat jane subjekt i ndryshimeve jo te rendesishme te vleres se tyre te drejte dhe perdoren nga Banka per permbushjen e angazhimeve te saj afatshkurtra.

Mjete monetare dhe te ngjashme mbahen ne bilanc me koston e amortizuar.

### (k) Huate dhe paradheniet per bankat dhe klientet

Huate dhe paradheniet per bankat dhe klientet jane aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose te percaktueshme te cilat nuk jane te kuotuara ne nje treg aktiv dhe Banka nuk ka per qellim shitjen e tyre te menjehershme ose ne nje kohe te afert. Huate dhe paradheniet maten ne fillim me koston e amortizimit plus kostot e tjera te transaksioneve direkte, duke perdorur metoden e interesit efektiv. Pas matjes fillestare, ato maten me koston e amortizimit me normen efektive te interesit, duke zbritur vleren e zhvleresimit. Amortizimi perfshihet ne te ardhurat nga interesi ne pasqyren e te ardhurave. Humbjet qe rezultojne nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave tek humbjet neto nga zhvleresimi i mjeteve financiare. Nuk ekzistojne zhvleresime te cilat njihen per huate dhe paradheniet Bankave sikunder percaktohet ne menyre te detajuar ne Shenimin 5, "Risku i kredise".

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### (l) Investime ne Letra me Vlere

Letrat me vlere kontabilizohen ne varesi te klasifikimit te tyre, si letra me vlere te investimit, letra me vlere te tregtueshme ose letra me vlere te vendosjes.

*(i) Letra me vlere te investimit*

Letrat me vlere te investimit jane aktive financiare jo derivative me te ardhura fikse ose te percaktueshme dhe me maturitete fikse qe Banka ka qellimin dhe aftesine t'i mbaje deri ne maturim dhe qe nuk klasifikohen si te tregtueshme ose letra me vlere te vendosjes.

Letrat me vlere te investimit maten me koston e amortizuar nepermjet metodes se interesit efektiv. Te gjitha shitjet dhe riklasifikimet e nje shume te konsiderueshme te letrave me vlere te investimit qe nuk jane afer maturimit riklasifikohen si investime ne letra me vlere te vendosjes dhe nuk e lejojne Banken t'i klasifikoje ato ne investime ne letra me vlere te investimit per vitin ushtrimor aktual dhe dy vitet ushtrimore te ardhshem.

*(ii) Letra me vlere te vendosjes*

Letrat me vlere te vendosjes jane instrumente jo derivative te cilat nuk perbejne nje kategori tjeter te aktiveve financiare. Te ardhurat nga interesi njihen ne pasqyren e te ardhurave nepermjet metodes se interesit efektiv. Te ardhurat nga dividentet njihen ne pasqyren e te ardhurave kur Banka gezon te drejten mbi dividentin. Fitimet ose humbjet nga kembimet valutore te investimeve ne letra me vlere te vendosjes njihen ne pasqyren e te ardhurave.

Ndryshime te tjera te vleres se drejte njihen direkt ne kapital deri sa investimi te shitet ose zhvleresohet, dhe gjendja ne kapital njihet me pas ne pasqyren e te ardhurave.

### (m) Ndertesat dhe pajisjet

*(i) Njohja dhe matja*

Ndertesat dhe pajisjet paraqiten me koston e tyre neto pasi iu eshte zbritur zhvleresimi i akumuluar dhe ndonje humbje nga zhvleresimi. Kostot perfshijne te gjitha shpenzimet te cilat mund t'i atribuohen ne menyre te drejtperdrejte blerjes se mjetit. Nese pjese te nje aktivi kane jete perdorimi te ndryshme, atehere keto pjese kontabilizohen si elemente te veçanta (perberesit kryesore) te ndertesave dhe pajisjeve.

*(ii) Kosto te tjera rrjedhese*

Kostot e zevendesimit te nje pjese te nje ndertese ose pajisjeje njihen me vleren e mbartur te aktivit nese eshte e mundur qe te sigurohen perfitime te ardhshme ekonomike dhe nese kostot e tij mund te maten ne menyre te besueshme.

*(iii) Zhvleresimi njihet ne pasqyren e te ardhurave duke perdorur metoden lineare pergjate kohezgjatjes se jetes se dobishme te çdo pjese te nderteses dhe pajisjes. Trualli dhe Veprat e Artit nuk zhvleresohen.*

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### (m) Ndertesat dhe pajisjet (vazhdim)

Ndryshimet ne jetegjatesine e pritshme te perdorimit kontabilizohen duke ngarkuar periudhen ose metoden e zhvleresimit ne varesi te rastit, dhe trajtohen si ndryshime ne perllogaritjet (parashikimet) kontabel.
Jetegjatesite e parashikuara te perdorimit per periudhen aktuale dhe periudhen krahasuese jane te paraqitura si me poshte:

| | |
|---|---|
| • Ndertesat | 20 vjet |
| • Mobiljet, orendite dhe pajisjet | 5 vjet |
| • Kompjuterat dhe pajisje te tjera kompjuterike | 4 vjet |

*(iv) Mos-njohja*

Ndertesat dhe pajisjet nuk njihen me ne momentin kur hiqen te drejtat dhe kontrolli mbi to dhe kur nga perdorimi i tyre asnje perfitim ekonomik ne te ardhmen nuk pritet te realizohet. Çdo humbje apo fitim nga mosnjohja e nje aktivi (te llogaritur si diference ndermjet te ardhurave nga vlera e shitjes dhe vleres se tij te mbartur) njihet ne kategorine "Te ardhura te tjera operacionale" ne pasqyren e te ardhurave ne vitin ne te cilin ndodh mosnjohja.

### (n) Aktive Afatgjata Jomateriale

Programet kompjuterike, liçensat dhe markat tregtare perbejne aktivet afatgjata jomateriale. Programet e blera nga Banka paraqiten me koston neto nga amortizimi i akumuluar.
Shpenzimet e metejshme ne aktivet afatgjata jomateriale kapitalizohen vetem nese keto shpenzime rrisin te mirat e ardhshme ekonomike te ketij mjeti specifik. Çdo lloj kostoje tjeter shpenzohet ne periudhen ne te cilen kryhet.
Amortizimi pasqyrohet te pasqyra e te ardhurave duke perdorur metoden lineare te amortizimit per te gjithe jetegjatesine e aktiveve afatgjata jomateriale. Mjetet e qendrueshme te patrupezuara amortizohen nga data e fillimit te perdorimit te tyre. Jetegjatesia e parashikuar per periudhen aktuale dhe krahasuese vijon si me poshte:

| | |
|---|---|
| • Programet kompjuterike | 4 vjet |
| • Liçensat dhe markat tregtare | 10 vjet |

### (o) Zhvleresimi i aktiveve jo financiare

Vlera e mbartur e aktiveve jo financiare te Bankes, te ndryshme nga aktivet tatimore te shtyra, rishikohet çdo date raportimi, per te percaktuar nese ka tregues te zhvleresimit. Ne rast se rezultojne tregues te tille, atehere perllogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbjet nga zhvleresimi njihen nese shuma e mbartur e nje aktivi ose njesie qe gjeneron te ardhura e tejkalon shumen e vleres se rikuperimit. Njesia qe gjeneron te ardhura eshte grupi me i vogel i aktivit, i identifikueshem qe gjeneron flukse te mjeteve monetare te cilat jane shume te pavaruara nga aktivet e tjera dhe grupet. Humbjet nga zhvleresimi njihen tek fitimi ose humbjet. Humbjet nga zhvleresimi lidhur me njesite e gjenerimit te te ardhurave shperndahen per te reduktuar shumen e mbartur te aktiveve te tjera ne njesi (grup njesish) ne menyre proporcionale.

## SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

# 4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### (o) Zhvleresimi i aktiveve jo financiare (vazhdim)

Vlera e rikuperueshme e nje aktivi ose njesie gjenerimi te te ardhurave eshte me e madhja prej vleres ne perdorim dhe vleres se drejte minus kostot per t'u shitur. Per vleresimin e vleres ne perdorim, fluksi i te ardhurave te parashikuara skontohet ne vlere aktuale me normen e zbritjes para tatimit e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut me vleren kohe te parase dhe risqet specifike te aktivit.

Humbjet nga zhvleresimi te njohura gjate periudhave te meparshme vleresohen ne daten e raportimit per te verifikuar nese ka tregues qe pasqyrohen se humbjet jane zvogeluar ose nuk jane me ekzistente. Humbjet nga zhvleresimi kthehen ne rast se ka pasur ndonje ndryshim ne perllogaritjet e bera per percaktimin e shumes se rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi kthehen vetem kur shuma e mbartur e aktivit nuk e tejkalon shumen e mbartur qe do te ishte percaktuar, pa zhvleresimin dhe amortizimin, nese nuk do te njihej asnje humbje nga zhvleresimi.

### (p) Depozitat dhe borxhet e varura

Depozitat dhe borxhet e varura perbejne burimet e financimit te Bankes. Kur Banka shet nje aktiv financiar dhe ne te njejten kohe nenshkruan nje marreveshje per riblerjen e aktivit (ose te nje aktivi te ngjashem) me çmim fiks ne nje date te me vone ("repo" ose "stock lending") marreveshja kontabilizohet si depozite, dhe aktivi ne fjale vazhdon te njihet ne pasqyrat financiare te Bankes.

Depozitat dhe borxhet e varura fillimisht maten me vleren e drejte plus kostot direkte te transaksionit, dhe me pas maten me koston e tyre te amortizuar duke perdorur metoden e normes efektive te interesit, perveçse nëse Banka vendos te mbarte detyrime me vleren e drejte nepermjet njohjes se fitimit ose humbjes.

### (q) Marreveshjet e riblerjes dhe marreveshjet e anasjellta te riblerjes

Letrat me vlere te blera sipas marreveshjeve per t'u rishitur (marreveshjet e anasjellta te riblerjeve) dhe letra me vlere te shitura sipas marreveshjeve per te riblere (marreveshjet per riblerje), trajtohen si transaksione financiare me kolateral ne formen e parapagimeve ose arketimeve plus interesin e perllogaritur.
Letrat me vlere te marra mbi bazen e marreveshjeve te riblerjes se anasjellte dhe letrat me vlere te dhena sipas marreveshjeve te riblerjes nuk njihen ose hiqen nga bilanci, derisa hiqet dore nga kontrolli i te drejtave kontraktuale te cilat perfshijne keto letra me vlere.
Interesat e fituara nga marreveshjet e riblerjeve te anasjellta dhe interesi i marreveshjeve te riblerjeve njihen si te ardhura nga interesat ose shpenzime interesi per secilen marreveshje, mbi jeten e çdo marreveshje. Te gjitha marreveshjet e riblerjes dhe marreveshjet e anasjellta jane kryer me Banken Qendrore te Shqiperise.

*Sigurimi me kolateral mjete monetare i marreveshjeve te riblerjes se anasjellte/marreveshjet e riblerjes.*

Transkasionet e huadhenies dhe huamarrjes se letrave me vlere ne pergjithesi jane te siguruara me letra me vlere ose mjete monetare. Transferimi i letrave me vlere kundrejt paleve pasqyrohet ne pasqyren e pozicionit financiar vetem nese transferohen edhe risqet dhe shperblimet e pronesise. Pagesa ose arketimi paraprak si kolateral regjistrohet si aktiv ose pasiv. Informacion me i detajuar pasqyrohet ne Shenimet 11 dhe 16.

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### (r) Provizionet

Nje provizion mund te njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje ne te kaluaren Banka disponon nje detyrim ligjor ose konstruktiv qe mund te vleresohet me besueshmeri dhe qe gjithashtu eshte e mundur qe te kerkoje dalje te perfitimeve ekonomike per te mbyllur detyrimin. Provizionet percaktohen duke perdorur si norme skontimi per flukset e pritshme te parase ne te ardhmen, nje norme para taksore e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe aty ku eshte e pershtatshme, edhe specifikat e riskut per detyrimin.

### (s) Garancite financiare

Garancite financiare jane kontrata qe kerkojne qe Banka te realizoje pagesa specifike per te rimbursuar mbajtesin e garancise per nje humbje qe ka ndodhur si rezultat i mungeses se pageses sipas termave kontraktore per nje instrument borxhi nga nje debitor i caktuar.
Detyrimet per garancite financiare njihen fillimisht me vleren e tyre te drejte, e cila amortizohet gjate jetes se garancise financiare. Rrjedhimisht detyrimi i garancise mbartet me vleren me te larte midis vleres se amortizuar dhe vleres aktuale te ndonje pagese te pritshme. (kur pagesa ne lidhje me garancine behet e mundshme).
Garancite financiare jane te perfshira tek detyrime te tjera.

### (t) Perfitimet e punonjesve

*(i) Planet e percaktuara te kontributeve*

Banka operon vetem me kontribute te detyrueshme te sigurimeve shoqerore qe sigurojne perfitime pensioni per personelin ne momentin e daljes ne pension. Autoritetet lokale jane pergjegjes per te siguruar minimumin e nivelit te pensionit sipas ligjit per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani te percaktuar kontributi per pensionin. Kontributet e Bankes ndaj perfitimeve te planit te pensionit pasqyrohen ne pasqyren e te ardhurave ne momentin kur ndodhin.

*(ii) Perfitimet afatshkurtra*

Detyrimet per perfitimet afatshkurter te punonjesve llogariten mbi nje baze te paskontueshme dhe njihen si shpenzime kur sherbimi perkates eshte siguruar. Nje provizion njihet per vleren e pritur per t'u paguar neqoftese Banka ka nje detyrim aktual ligjor ose konstruktiv per te paguar kete shume si rezultat i nje sherbimi te kryer ne te kaluaren nga punonjesi dhe ky detyrim mund te vleresohet ne menyre te besueshme.

### (u) Deklarata te reja (standarde te reja, ndryshimet/rishikimet e standardeve ose interpretimeve te tyre) ne fuqi per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2011.

*(i) Standardet e nxjerra dhe ne fuqi*

*Interpretimet dhe amendimet (ndryshimet) e standardeve te meposhtme u bene te detyrueshme per here te pare per vitin financiar te filluar me 1 Janar 2011:*

- **SNK 24 "Dhenia e Informacioneve per Palet e Lidhura" (Rishikuar),**

BSNK nxorri nje amendim per SNK 24 i cili sqaron përkufizimin e nje pale te lidhur. Perkufizimi i ri thekson nje kendveshtrim simetrik te marredhenieve me pale te lidhura dhe sqaron rrethanat ne te cilat personat dhe drejtuesit kryesore ndikojne ne marredheniet me palet e lidhura te nje subjekti. Gjithashtu, amendimi prezanton nje perjashtim nga kerkesat per dhenien e informacionit per transaksionet me qeverine dhe subjektet te cilat kontrollohen, kontrollohen se bashku ose kane ndikim te madh nga e njejta qeveri si subjekti raportues. Ndryshimi aplikohet ne baze retrospektive. Amendimi eshte vlerësuar se nuk do te kete asnje ndikim ne pasqyrat financiare te Bankes.

## SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

- **SNK 32 Instrumentat Financiare: Paraqitja – (Rishikuar)**

BSNK nxorri nje amendim i cili ndryshon perkufizimin e nje detyrimi financiar te SNK 32 per te bere te mundur qe subjektet te klasifikojne te drejtat qe zoterojne dhe disa opsioneve ose garanci te caktuara si instrumenta kapitali. Amendimi eshte i zbatueshem nese keto te drejta jane dhene ne menyre prorporcionale tek te gjithe pronaret ekzistues te se njejtes klase te instrumentave jo-derivative te kapitalit te subjektit, ose per te blere nje numer te caktuar te instrumentave te kapitalit te vete njesise per nje shume te caktuar ne cfaredo monedhe. Ky ndryshim aplikohet ne menyre retrospektive. Amendimi eshte vlerësuar se nuk do te kete asnje ndikim ne pasqyrat financiare te Bankes.

*(ii) Standarde te publikuara po akoma jo ne fuqi*

*Standartet e publikuara po akoma jo ne fuqi deri ne daten e hartimit te pasqyrave financiare te bankes paraqiten me poshte. Kjo liste paraqet standartet dhe interpretimet e publikuara, te cilat Banka pritet t'i zbatoje ne te ardhmen. Banka planifikon t'i adoptoje keto ndryshime ne momentin e hyrjes se tyre ne fuqi.*

- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare (Rishikuar) - Paraqitja e zerave te tjere te te ardhurave gjithperfshirese.**

Amendimi hyn ne fuqi per periudhat vjetore te cilat fillojne ne daten ose pas dates 1 Korrik 2012. Ndryshimet e SNK 1 ndryshojne klasifikimin e zerave te cilat paraqiten ne te ardhurat e tjera gjitheperfshirese. Zerat te cilet mund te riklasifikohen (ose riciklohen) ne pasqyren e fitimit ose humbjes ne nje moment kohor ne te ardhmen (pershembull pas mos-njohjes ose likuidimit) do te paraqiten veçmas nga zerat te cilet nuk do te riklasifikohen asnjehere. Banka eshte ne proces te vlerësimit te impaktit te këtij ndryshimi ne paraqitjen e pasqyrave te saj financiare.

## SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### (u) Deklarata te reja (vazhdim)

*(ii) Standarde te publikuara po akoma jo ne fuqi (vazhdim)*

- **SNK 12 Tatimi mbi fitimi (Rishikuar) – Rikuperimi i aktiveve.**

Amendimi hyn ne fuqi per periudhat vjetore te cilat fillojne ne ose pas dates 1 Janar 2012. Ndryshimi sqaron percaktimin e tatimit te shtyre per aktivet afatgjata te investimit qe maten me vleren e drejte. Ndryshimi prezanton nje supozim te kundërshtueshem qe tatimi i shtyre per aktivet afatgjata te investimit i cili matet sipas modelit te vleres se drejte ne SNK 40 duhet te percaktohet duke u bazuar ne faktin se vlera kontabel neto e tij do te rikuperohet me ane te shitjes. Gjithashtu, ky ndryshim paraqet kerkesen qe tatimi i shtyre per aktivet qe nuk zhvlerësohen te cilat maten nepermjet perdorimit te modelit te rivleresimit ne SNK 16, te matet gjithmone ne baze te shitjes se aktivit. Banka eshte duke vleresuar ndikimin e ketij ndryshimi tek gjendja financiare ose ecuria e bankes; megjithatë duhet te theksohet se Banka aktualisht nuk ka aktive afatgjata per investim.

- **SNK 19 Perfitimet per punonjësit (Rishikuar).**

Amendimi hyn ne fuqi per periudha vjetore te cilat fillojne ne ose pas dates 1 Janar 2013. BSNK ka nxjerre disa amendime te SNK 19. Keto variojne nga ndryshimet thelbesore si heqja e mekanizmit te intervalit dhe konceptit te kthimeve te pritshme nga aktivet deri ne sqarime te thjeshta dhe riformulime. Zbatimi i hershem i ketij standardi lejohet. Banka do te vleresoje ndikimin dhe impaktin e këtij amendimi ne pozicionin financiar ose ecurine e Bankes.

- **SNK 27 “Pasqyrat Financiare Individuale” (Rishikuar)**

Standardi hyn ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas dates 1 Janar 2013. Si rezultat i SNRF 10 dhe SNRF 12 te re, ajo qe mbetet nga SNK 27 kufizohet ne kontabilitetin per filialet, per subjekte te kontrolluara bashkërisht, dhe pjesemarrjet ne pasqyrat financiare individuale. Lejohet zbatimi me i hershem i këtij standardi. Banka do te vleresoje ndikimin dhe impaktin e ketij amendimi ne pozicionin financiar ose ecurine e bankes; megjithate SNK 27 nuk eshte per momentin relevante per operacionet e Bankes.

- **SNK 28 Investime ne Pjesemarrje dhe Sipermarrje te Perbashketa (Rishikuar).**

Standardi hyn ne fuqi per periudha vjetore te cilat fillojne ne ose pas dates 1 Janar 2013. Si rezultat i standardeve te reja SNRF 11 dhe SNRF 12, SNK 28 eshte riemërtuar SNK 28 Investime ne Pjesemarrje dhe Sipermarrje te Perbashketa, dhe përshkruan zbatimin e metodes se kapitalit per investime ne sipërmarrje te perbashketa krahas pjesemarrjeve. Lejohet zbatimi i hershem i këtij standardi. Banka do te vleresoje ndikimin e këtij ndryshimi ne pozicionin financiar ose ecurine e bankes; megjithate SNK 28 nuk eshte per momentin relevante per operacionet e Bankes.

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### (u) Deklarata te reja (vazhdim)

*(ii) Standarde te publikuara po akoma jo ne fuqi (vazhdim)*

- **SNK 32 Instrumentet financiare: Paraqitja (Rishikuar) – Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare.**

Amendimi hyn ne fuqi per periudhat vjetore qe fillojne ne dhe pas dates 1 Janar 2014. Ky amendim sqaron kuptimin "aktualisht ka te drejte te zbatueshme per kompensim" dhe gjithashtu sqaron zbatimin e kritereve te kompensimit per sistemet e likuidimit sipas SNK 32 (si zyrat qendrore te kleringut) te cilat zbatojne mekanizma bruto likuidimi qe nuk jane te njëkohshme. Ndryshimi i SNK 32 do te zbatohet ne menyre retrospektive. Zbatimi i hershem i këtij standardi lejohet. Megjithate, nese nje subjekt vendos t'a aplikoje me heret, ai duhet te prezantoje kete fakt si dhe te paraqese te dhenat sikurse kerkohen ne zbatim te SNRF 7 Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare. Banka do te vleresoje ndikimin e këtij amendimi ne pozicionin financiar ose ne ecurine e Bankes.

- **SNRF 7 Instrumentet financiare: Dhenia e informacioneve (Rishikuar) – Kerkesat e permiresuara per dhenien e informacioneve shpjeguese per mos-njohjen (çregjistrimin).**

Amendimi hyn ne fuqi per periudha vjetore te cilat fillojne ne ose pas dates 1 Korrik 2011. Amendimi kerkon paraqitjen e te dhenave te tjera per mjetet financiare te cilat jane transferuar por nuk jane njohur per te mundesuar qe perdoruesi i pasqyrave financiare te kuptoje marredhenien me keto mjete te cilat nuk jane njohur dhe detyrimet e lidhura me to. Gjithashtu, amendimi kerkon paraqitjen e informacioneve shpjeguese per perfshirjen e vazhdueshme ne aktivet qe çregjistrohen per te bere te mundur qe përdoruesi i pasqyrave financiare te vleresoje natyren, rreziqet qe lidhen me perfshirjen e vazhdueshme te subjektit ne keto aktive qe nuk njihen (çregjistrohen). Amendimi ka efekt vetem ne kerkesat per dhenien e informacioneve shpjeguese.

- **SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhenia e informacioneve (Rishikuar) – Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare.**

Amendimi hyn ne fuqi per periudha vjetore te cilat fillojne ne ose pas dates 1 Janar 2013. Amendimi paraqet kerkesat per zbulimin e te dhenave. Zbulimi i ketyre te dhenave do t'i siguroje përdoruesit informacionin e nevojshem per vlerësimin e efektit ose efekteve te mundshme te marrëveshjeve te kompensimit ne pozicionin financiar te subjektit. Amendimet e SNRF 7 do te zbatohen ne menyre retrospektive. Banka do te vleresoje ndikimin e këtij amendimi ne pozicionin financiar ose ne ecurine e Bankes.

- **SNRF 9 Instrumentat Financiare: Klasifikimi dhe Matja.**

Standardi i ri hyn ne fuqi per periudhat vjetore qe fillojne ne ose pas dates 1 Janar 2015. SNRF 9 paraqet fazen e pare te punes se BSNK per zevendesimin e SNK 39 dhe aplikohet ne klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare sikurse percaktohet ne SNK 39. Faza e pare e SNRF 9 do te kete nje ndikim te rendesishem mbi (i) klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe (ii) nje ndryshim ne raportim per

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### (u) Deklarata te reja (vazhdim)

*(ii) Standarde te publikuara po akoma jo ne fuqi (vazhdim)*

**SNRF 9 Instrumentat Financiare: Klasifikimi dhe Matja (vazhdim)**

ato subjekte te cilat i kane percaktuar detyrimet financiare duke perdorur metoden e vleres se drejte. Ne fazat e mevonshme, BSNK do te adresoje zhvleresimet dhe kontabilitetin e zerave te mbrojtur. Perfundimi i ketij projekti pritet ne mes te vitit 2012. Aplikimi i hershem i ketij standardi lejohet. Banka do te vleresoje ndikimin e standardit te ri ne pozicionin financiar ose ecurine e Bankes.

- **SNRF 10 Pasqyrat financiare te konsoliduara.**

Standardi i ri hyn ne fuqi per periudhat vjetore te cilat fillojne ne dhe pas dates 1 Janar 2013. SNRF 10 zevendeson pjesen e SNK 27 Pasqyra Financiare te Konsoliduara dhe Individuale te cilat adresojne kontabilitetin per pasqyrat financiare te konsoliduara. Gjithashtu perfshin çështjet e ngritura ne SIC-12 Konsolidimi – Subjekte me qellim te posaçem. SNRF 10 percakton nje model te vetem kontrolli i cili zbatohet per te gjitha subjektet, perfshi dhe subjektet me qellim te posacem. Ndryshimet qe paraqet SNRF 10 i kerkojne menaxhimit te ushtroje gjykimin e duhur per te percaktuar se cilat subjekte kontrollohen dhe per kete arsye duhet te konsolidohen nga kompania meme, ne krahasim me kerkesat e parashikuara ne SNK 27. Banka do te vleresoje ndikimin e standardit te ri ne pozicionin financiar ose ecurine e Bankes; megjithate SNRF 10 per momentin nuk eshte relevante per operacionet e Bankes.

- **SNRF 11 Marreveshjet e perbashketa.**

Standardi i ri hyn ne fuqi per periudha vjetore te cilat fillojne ne ose pas dates 1 Janar 2013. SNRF 11 zevendeson SNK 31 Interesi per Sipermarrjet e Perbashketa dhe SIC-13 Subjekte te kontrolluara bashkerisht – Kontributet jo-monetare nga Sipermarrjet. SNRF 11 heq opsionin e kontabilizimit per subjektet te cilat kontrollohen bashkerisht (JSE) duke perdorur konsolidimin proporcional. Perkundrazi, subjektet e kontrolluara bashkerisht te cilat plotesojne perkufizimin e sipermarrjes se perbashket duhet te kontabilizohen duke perdorur metoden e kapitalit. Banka do te vleresoje ndikimin e standardit te ri ne pozicionin financiar ose ecurine e Bankes; megjithate SNRF 11 per momentin nuk eshte relevante per operacionet e Bankes.

- **SNRF 12 Shenime shpjeguese per përfshirjen me subjekte te tjera.**

Standardi i ri hyn ne fuqi per periudha vjetore te cilat fillojne ne ose pas dates 1 Janar 2013. SNRF 12 perfshin te gjitha shenimet shpjeguese qe me pare kane qene perfshire ne SNK 27 per pasqyrat financiare te konsoliduara si dhe te gjitha shenimet shpjeguese qe me pare jane perfshire ne SNK 31 dhe SNK 28. Shenimet shpjeguese lidhen me interesat e subjektit ne filialet, marreveshjet e perbashketa, pjesemarrjet dhe subjektet e strukturuara. Gjithashtu kerkohen edhe disa shenime shpjeguese te reja. Banka do te vleresoje ndikimin e standardit te ri ne pozicionin financiar ose ecurine e Bankes; megjithate SNRF 12 per momentin nuk eshte relevante per operacionet e bankes.

## SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

# 4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

**(u) Deklarata te reja (vazhdim)**

*(ii) Standarde te publikuara po akoma jo ne fuqi (vazhdim)*

- **SNRF 13 Matja me vlere te drejte.**

Standardi i ri hyn ne fuqi per periudha vjetore te cilat fillojne ne ose pas dates 1 Janar 2013. SNRF 13 percakton nje burim te vetem udhezimi sipas SNRF per te gjitha matjet me vlere te drejte. SNRF 13 nuk ndryshon kur nje subjekt duhet te perdore vleren e drejte, por ofron udhezime lidhur me menyren e matjes se vleres se drejte sipas SNRF kur vlera e drejte eshte e kerkuar ose e lejuar. Ky standard duhet te zbatohet ne menyre prospektive dhe lejohet zbatimi i hershem i saj. Banka do te vleresoje ndikimin e standardit te ri ne pozicionin financiar ose ecurine e Bankes.

*(iii) Permiresime ne IFRS (publikuar ne Maj 2010)*

Ne Maj 2010, BSNK nxorri përmbledhjen e trete te ndryshimeve te standarteve, kryesisht me qellim heqjen e papajtueshmërive dhe sqarimin e formulimit. Ekzistojne dispozita te veçanta te përkohshme per secilin standard. Ndryshimet renditen me poshte:

SNRF 3 Kombinimet per Biznesin
SNRF 7 Instrumentet Financiare – Shenime Shpjeguese
SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare
SNK 27 Pasyrat Financiare te Konsoliduara dhe Individuale
SNK 34 Raportimi i Perkohshem Financiar
KIRFN 13 Programet per Besnikerine e Klientit

Megjithate Banka nuk parashikon qe adoptimi i ketyre ndryshimeve te kete impakt ne pozicionin financiar apo performancen e saj.

## SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

# 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Si pasoje e perdorimit te instrumentave financiare, Banka ekspozohet ndaj risqeve te meposhtem:

- risku i kredise
- risku i likuiditetit
- risku i tregut
- risku operacional

Ky shenim jep informacion rreth ekspozimit te Bankes ndaj secilit prej llojeve te risqeve, objektivat e Bankes, politikat dhe proceset per vleresimin dhe menaxhimin e riskut si dhe menaxhimin e kapitalit te Bankes.

### Kuadri i Menaxhimit te Riskut

Bordi i Drejtoreve te Bankes ka pergjegjesi te plote per vendosjen dhe mbikqyrjen e struktures se menaxhimit te riskut te Bankes. Bordi ka krijuar Komitetin e Aseteve dhe Detyrimeve dhe nje Komitet Lokal te Riskut te Kredise dhe Komitetin per Cilesine e Aktiveve, te cilet jane pergjegjes per marrjen e vendimeve ne fushat e tyre specifike, e mbeshteten nga Divizioni i Finances dhe Tregut Kapital dhe Divizioni i Menaxhimit te Riskut, te cilet jane pergjegjes per zhvillimin dhe monitorimin e politikave te menaxhimit te riskut te Bankes ne keto fusha. Te gjitha komitetet e Bordit kane anetare ekzekutive dhe joekzekutive dhe raportojne rregullisht tek Keshilli Drejtues lidhur me aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit te riskut te Bankes jane krijuar per te identifikuar dhe analizuar riskun me te cilin perballet Banka, per te vendosur limitet dhe kontrollin e duhur si dhe per te monitoruar risqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat e menaxhimit te riskut rishikohen rregullisht per te reflektuar ndryshimet ne kushtet e tregut si dhe produktet dhe sherbimet e ofruara. Aktualisht Banka ka ndertuar nje kuader te avancuar per drejtimin e risqeve financiare, nepermjet: implementimit te nje programi kompjuterik per Menaxhimin e Aktiveve dhe Detyrimeve dhe prezantimit te metodologjive e standarteve drejtuese te reja lidhur me te. Synimi i saj eshte te zhvilloje nje hapesire kontrolli konstruktive dhe te disiplinuar, ne te cilen te gjithe punonjesit te kuptojne rolet dhe detyrimet e tyre.

### Risku i Kredise

Ne aktivitetin normal bankar, Banka eshte e ekspozuar ndaj riskut te kredise ne huadheniet dhe paradheniet ndaj klienteve dhe institucioneve financiare, investimet ne letra me vlere dhe zerave te tjere jashte bilancit.
Risku i kredise eshte risku i nje humbjeje financiare te Bankes nese nje klient ose pale e ngjashme qe posedon nje instrument financiar deshton ne realizimin e detyrimeve kontraktore qe burojne nga huadhenia e Bankes ndaj klienteve, institucioneve financiare ose qe burojne nga zera te tjere jashte bilancit. Per arsye raportimi te menaxhimit te riskut Banka konsideron dhe konsolidon te gjithe elementet e ekspozimit te kredise ndaj riskut (risku individual i mospermbushjes se detyrimeve, risku i sektoreve te ekonomise si dhe risku lokal). Banka e menaxhon ekspozimin e saj ndaj riskut te kredise periodikisht duke monitoruar nga afer limitet e kredise, portofolin e huave dhe perqendrimin e ekspozimit.

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR ( VAZHDIM)

### Menaxhimi i Riskut te Kredise

Keshilli Drejtues i Bankes i ka deleguar pergjegjesi per marrjen e vendimeve Drejtorit te Pergjithshem Ekzekutiv, i cili ka deleguar Komitetit Lokal te Kredise kompetenca per vendimmarrje. Divizioni per Administrimin e Riskut, i cili raporton tek DPE, eshte pergjegjes per mbikqyrjen dhe administrimin e riskut te kredise se Bankes, duke perfshire detyrat e meposhtme:

- *Formulon politika kredie* duke u konsultuar me njesite e biznesit, mbuluar kerkesat per kolateral, vleresuar kredine, nivelin e riskut dhe raportimin, procedurat e dokumentacionit dhe ato ligjore, si dhe perputhshmerine me kerkesat rregullative dhe statutore.
- *Rishikon dhe vlereson riskun e kredise.* Departamenti i Kredise vlereson te gjitha ekspozimet e kredise qe e kane tejkaluar limitin e caktuar, perpara angazhimeve me klientet nga banka. Rishikimet dhe kontrolli i kushteve te kredise jane objekt i te njejtit proces kontrolli.
- *Kufizon perqendrimin e ekspozimit* ndaj paleve, gjeografikisht dhe per nga industria, (per huadhenie dheparadhenie) si dhe sipas leshuesit, likuiditetit te tregut dhe vendit (per letrat me vlere).
- *Zhvillon dhe miremban klasifikimin e riskut te Bankes* ne menyre qe te kategorizoje ekspozimet sipas nivelit te riskut te humbjes financiare qe perballet si dhe te fokusoje menaxhimin e risqeve te tjere shoqerues. Klasifikimi i riskut perdoret per te percaktuar nevojen e provigjionimit te demeve ndaj ekspozimeve specifike te kredise. Ne perputhje me metodologjine e Bankes te gjitha ekspozimet jane te klasifikuara si ekspozime pa probleme dhe ato me probleme si me poshte:

| **Klasifikimi sipas SNRF** | | |
|---|---|---|
| **Permbledhje e Klasifikimeve** | **Klasifikimi sipas Metodologjise se Bankes** | **Kritere Objektive** |
| **Pa probleme** | A | *Ekspozime te konsiderueshme,* |
| | | *> 10% KR, Dite-Vonesat < 61 dite* |
| | | *Ekspozimet e punonjesve te Bankes* |
| | | *Kolektive, Dite Vonesat < 61 dite* |
| | B | *Te cilesuara (trajtim I vecante)* |
| | | *Dite Vonesat 61-90 dite* |
| **Me probleme** | C (perfshin ekspozimet Ne Ndjekje) | *Dite Vonesat 91-180 dite* |
| | D (perfshin ekspozimet Nen Standarte) | *Dite Vonesat 181-270 dite* |
| | E (perfshin ekspozimet e Dyshimta) | *Dite Vonesat > 270 dite* |
| | Te ristrukturuara | |

- *Rishikon perputhshmerine* e njesive te biznesit me limitet e ekspozimit te miratuara duke perfshire ato per industrite e zgjedhura dhe llojet e produkteve. Komitetit Lokal te Kredive i sigurohen raporte mujore te detajuara mbi cilesine e kredive te portofoleve lokale ku gjithashtu paraqitet dhe tendenca e tyre dhe veprimet rregulluese te duhura qe duhen nderrmarre. Ky informacion i paraqitet Komitetit te Kontrollit dhe Keshillit Drejtues çdo tremujor.
- *Ofron konsulten, drejtimin dhe aftesite profesionale* ndaj njesive te biznesit per te promovuar ne Banke praktiken me te mire te menaxhimit te riskut te kredise.

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR ( VAZHDIM)

### Menaxhimi i Riskut te Kredise (vazhdim)

### Ekspozimi Maksimal ndaj Riskut te Kredise pa marre ne konsiderate kolateralet apo ndonje lehtesi tjeter kreditore (bruto nga ndonje zhvleresim)

Tabela e meposhtme tregon ekspozimin aktual maksimal ndaj riskut te kredise per komponentet e aplikueshem te bilancit:

| | Ekspozimi Maksimal Bruto | |
|---|---|---|
| | **31 Dhjetor 2011** | **31 Dhjetor 2010** |
| Llogarite me Banken Qendrore (duke perjashtuar Arken) | 7,704,636 | 8,146,724 |
| Hua dhe paradhenie bankave | 16,530,111 | 10,498,496 |
| Hua dhe paradhenie klienteve | 51,552,478 | 48,883,302 |
| Aktive financiare-letra me vlere te vendosjes | 1,865,935 | 2,668,123 |
| Aktive financiare-letra me vlere te investimit | 51,572,399 | 49,641,226 |
| **Totali** | **129,225,559** | **119,837,872** |
| Huadhenie te aprovuara por jo te disbursuara | 3,742,979 | 6,091,313 |
| Leter Kredi | 3,527,847 | 3,894,440 |
| Garanci te dhena ne favor te klienteve | 3,752,284 | 4,127,857 |
| **Totali i angazhimeve ne lidhje me kredine** | **11,023,110** | **14,113,610** |
| **Totali i Ekspozimit ndaj Riskut te Kredise** | **140,248,669** | **133,951,482** |

Ekspozimi maksimal i kredise kundrejt nje klienti apo grupi klientesh ne 31 Dhjetor 2011 eshte 3,277,538 mije Lek (2010: 2,602,155 mije Lek) perpara marrjes ne konsiderate te kolateraleve apo ndonje lehtesie tjeter te kredise.

Aty ku mjetet financiare regjistrohen me vleren e drejte, shumat e pasqyruara tregojne ekspozimin e riskut te kredise, por jo ekspozimin maksimal te riskut i cili mund te rezultoje ne te ardhmen si rezultat i ndryshimeve te vleres.

Banka i mundeson klienteve te saj garanci te cilat mund te kerkojne qe Banka te kryeje pagesa ne perfitim te tyre dhe ndermerr angazhime per te shtrire me tej linjat e kredise per te siguruar nevojat e tyre te likuiditetit. Leter kredite dhe garancite e angazhojne Banken ne kryerjen e pagesave ne perfitim te klienteve ne rast te nje akti specifik, pergjithesisht i lidhur me importin dhe eksportin e mallrave. Te tilla angazhime e ekspozojne Banken ne risqe kredie te ngjashme, te cilat zbuten nga te njejtat procedura dhe politika kontrolli.

Çdo muaj Banka vlereson angazhimet e saj financiare per ndonje zhvleresim te mundshem. Subjekt i vleresimit individual per zhvleresime te mundshme te ketyre angazhimeve jane huate e klienteve me probleme ose huate e atyre klienteve qe jane ristrukturuar.

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

### Risku i Kredise (vazhdim)

### Cilesia e Kredise sipas klasave te aktiveve financiare

Tabelat me poshte tregojne cilesine e kredise per aktivet financiare te ekspozuara kundrejt riskut te kredise, bazuar ne klasifikimet e brendshme te Bankes. Huate e vonuara por qe nuk jane zhvleresuar testohen ne menyre individuale dhe kolaterali i tyre apo rritja e kredive rrisin riskun ndaj te cilit ekspozohet Banka. Zhvleresimi kolektiv shpërndahet sipas normes se përcaktuar te grupit me karakteristika te ngjashme kredie ku klientet jane klasifikuar.

Aktivet financiare ne tabelen e meposhtme paraqiten bruto pa zbritjet per zhvleresimet per te dy vitet financiare me 31 Dhjetor 2011 dhe 31 Dhjetor 2010:

| 31 Dhjetor 2011 | As me vonese as te zhvleresuara | Me vonese por jo te zhvleresuara | Individualisht te zhvleresuara | Totali |
|---|---|---|---|---|
| Llogari me Banken Qendrore (duke perjashtuar Arken) | 7,704,636 | - | - | 7,704,636 |
| Hua dhe paradhenie bankave | 16,530,111 | - | - | 16,530,111 |
| Hua dhe paradhenie klienteve: | | | | |
| Hua tregtare | 29,564,995 | 3,927,958 | 9,562,181 | 43,055,134 |
| Hua hipotekore | 4,988,898 | 616,233 | 1,289,579 | 6,894,710 |
| Hua konsumatore | 1,249,929 | 58,671 | 399,255 | 1,707,855 |
| Komision disbursimi, i shtyre | (97,855) | (6,796) | (570) | (105,221) |
| Aktive financiare-letra me vlere te vendosjes: | | | | |
| Kompani te Listuara | 1,287,521 | - | - | 1,287,521 |
| Kompani jo te Listuara | 578,414 | - | - | 578,414 |
| Aktive financiare-letra me vlere te investimit: | | | | |
| Kompani te Listuara | 7,619,640 | - | - | 7,619,640 |
| Kompani jo te Listuara | 43,952,759 | - | - | 43,952,759 |
| **Totali** | **113,379,048** | **4,596,066** | **11,250,445** | **129,225,559** |

| 31 Dhjetor 2010 | As me vonese as te zhvleresuara | Me vonese por jo te zhvleresuara | Individualisht te zhvleresuara | Totali |
|---|---|---|---|---|
| Llogarite me Banken Qendrore (duke perjashtuar Arken) | 8,146,724 | - | - | 8,146,724 |
| Hua dhe paradhenie bankave | 10,498,496 | - | - | 10,498,496 |
| Hua dhe paradhenie klienteve: | | | | |
| Hua tregtare | 24,985,904 | 7,022,441 | 7,891,286 | 39,899,631 |
| Hua hipotekore | 4,940,287 | 1,065,453 | 715,801 | 6,721,542 |
| Hua konsumatore | 1,735,583 | 265,950 | 351,241 | 2,352,774 |
| Komision disbursimi, i shtyre | (81,999) | (5,657) | (2,988) | (90,644) |
| Aktive financiare-letra me vlere te vendosjes: | | | | |
| Kompani te Listuara | 1,885,506 | - | - | 1,885,506 |
| Kompani jo te Listuara | 782,617 | - | - | 782,617 |
| Aktive financiare-letra me vlere te investimit: | | | | |
| Kompani te Listuara | 6,923,042 | - | - | 6,923,042 |
| Kompani jo te Listuara | 42,718,184 | - | - | 42,718,184 |
| **Totali** | **102,534,345** | **8,348,187** | **8,955,340** | **119,837,872** |

Ne huate me vonese me siper jane perfshire kredite qe jane me shume se 60 dite me vonese.

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

### Risku i Kredise (vazhdim)

Hua dhe paradhenie klienteve eshte klasa e vetme e aktiveve financiare te rezultuara me vonese e jo te zhvleresuara. Pjesa tjeter e aktiveve financiare nuk ka ndonje kategori me vonese. Analiza e tyre respektive, sipas kohe voneses me 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 paraqitet si me poshte:

| 31 Dhjetor 2011 | 61 ne 90 dite | 91 ne 180 dite | me shume se 180 dite | Totali |
|---|---|---|---|---|
| Hua dhe paradhenie klienteve: | | | | |
| Hua tregtare | 264,442 | 746,830 | 2,916,686 | 3,927,958 |
| Hua hipotekore | 112,364 | 319,465 | 184,404 | 616,233 |
| Hua konsumatore | 4,743 | 9,882 | 44,047 | 58,672 |
| Komision disbursimi, i shtyre | (1,356) | (5,441) | - | (6,797) |
| **Totali** | **380,193** | **1,070,736** | **3,145,137** | **4,596,066** |

| 31 Dhjetor 2010 | 61 ne 90 dite | 91 ne 180 dite | me shume se 180 dite | Totali |
|---|---|---|---|---|
| Hua dhe paradhenie klienteve: | | | | |
| Hua tregtare | 1,352,951 | 2,397,443 | 3,272,046 | 7,022,440 |
| Hua hipotekore | 176,676 | 249,477 | 639,300 | 1,065,453 |
| Hua konsumatore | 9,962 | 14,082 | 241,907 | 265,951 |
| Komision disbursimi, i shtyre | (2,039) | (1,511) | (2,108) | (5,657) |
| **Totali** | **1,537,551** | **2,659,491** | **4,151,145** | **8,348,187** |

### Vlera e mbartur sipas klasave te aktiveve financiare per te cilat kushtet jane rinegociuar.

Tabela me poshte tregon vleren e mbartur te huave dhe paradhenieve per klientet, te cilat jane rinegociuar/riskeduluar, sipas produkteve:

| | 31 Dhjetor 2011 | 31 Dhjetor 2010 |
|---|---|---|
| Hua tregtare | 807,977 | 537,960 |
| Hua hipotekore | 128,367 | 130,609 |
| Hua konsumatore | 7,657 | 5,013 |
| **Totali** | **944,001** | **673,582** |

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

### Risku i Kredise (vazhdim)

### Huate dhe letrat me vlere te zhvleresuara

Huate dhe letrat me vlere te zhvleresuara jane ato per te cilat Banka vlereson se mund te mos jete ne gjendje te mbledhe principalin dhe interesin e arketueshem sipas kushteve kontraktuale te marreveshjes se huase. Banka i klasifikon huadheniet dhe parapagimet ndaj klienteve ne kategori pa probleme dhe me probleme ne perputhje me metodologjise e Bankes sipas SNRF; nderkohe qe kryen teste te zhvleresimit per te gjitha huadheniet qe shfaqin prova objektive per zhvleresim, duke vleresuar te skontuar fluksin e ardhshem te parase dhe duke e krahasuar me shumen e mbetur per huate respektive.

Huate, provat objektive te te cilave nuk permbushin kushtet per t'u testuar individualisht si te zhvleresuara, testohen se bashku duke perdorur normat historike te Bankes per deshtimin e kredive dhe kthimin ose zgjidhjen e zhvleresimit per grupe kredish me karakteristika te ngjashme te riskut. Zhvleresimi kolektiv shperndahet per kliente te testuar individualisht por qe kane rezultuar te mos kene nevoje per zhvleresim individual.

### Zbritjet per zhvleresim

Banka percakton nje fond per humbjet nga kredite e zhvleresuara qe perfaqeson nje perllogaritje per humbjet ne portofolin e kredive. Komponentet kryesore te kesaj zbritjeje jane nje komponent i humbjes specifike qe lidhet me ekspozimet e rendesishme individuale, dhe nje zbritje per humbjet ne huate e vleresuara kolektivisht, te vendosura per grupe asetesh homogjene ne lidhje me humbjet qe kane ndodhur por qe nuk jane identifikuar ne huate objekt i vleresimit individual per zhvleresim.

Tabela me poshte tregon ekspozimin neto te huave dhe paradhenieve per klientet e klasifikuar ne dy grupe kryesore: individualisht ose kolektivisht te zhvleresuara

| | Ekspozimi Neto i huave dhe paradhenieve klienteve | |
|---|---|---|
| | **31 Dhjetor 2011** | **31 Dhjetor 2010** |
| *Individualisht te zhvleresuara* | 11,250,445 | 8,956,389 |
| Zbritja per humbjet nga zhvleresimi | (3,440,886) | (2,708,321) |
| **Vlera neto** | **7,809,559** | **6,248,068** |
| *Kolektivisht te zhvleresuara* | | |
| Shuma bruto | 40,302,032 | 39,926,914 |
| Zbritja per humbjet nga zhvleresimi | (679,305) | (421,190) |
| **Vlera neto** | **39,622,727** | **39,505,724** |
| **Total i Huave dhe paradhenieve per klientet** | **47,432,286** | **45,753,791** |

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

### Risku i Kredise (vazhdim)

Levizjet e veçanta te zbritjeve per zhvleresime individuale e kolektive paraqiten ne Shenimin 12.

Me poshte paraqitet nje analize e shumave bruto dhe neto (e zbritjeve per zhvleresime) per huate e zhvleresuara individualisht sipas klasifikimit te riskut:

| | Hua dhe paradhenie klienteve individualisht te zhvleresuara | |
|---|---|---|
| **31 Dhjetor 2011** | **Bruto** | **Neto** |
| Hua ne ndjekje | 612,364 | 454,076 |
| Hua nen standarte | 223,937 | 182,659 |
| Hua te dyshimta | 9,470,233 | 6,487,305 |
| Hua te ristrukturuara | 943,911 | 685,520 |
| **Totali** | **11,250,445** | **7,809,560** |
| **31 Dhjetor 2010** | | |
| Hua Standarte & Ne ndjekje | 1,914,945 | 1,388,841 |
| Hua nen standarte | 848,075 | 670,079 |
| Hua te dyshimta | 5,519,787 | 3,600,864 |
| Hua te humbura | 673,582 | 588,284 |
| **Totali** | **8,956,389** | **6,248,068** |

### Politikat e fshirjes nga librat kontabel

Banka fshin nga librat nje huadhenie (dhe zbritjet per zhvleresime nga humbje te lidhura me te) kur Bordi i Drejtoreve te Bankes percakton se kredia eshte e pambledhshme. Ky vendim arrihet pas marrjes ne konsiderate te informacionit per ndodhjen e ndryshimeve te rendesishme ne pozicionin financiar te huamarresit, ne menyre te tille qe huamarresi nuk paguan dot me detyrimet ose kolaterali nuk do te jete i mjaftueshem per te shlyer te gjithe ekspozimin.

Ashtu si tregohet dhe ne shenimin 4, fluksi i parashikuar i te ardhurave nga kolateralet dhe/ose garancive qe mbulojne ekspozimet konsiderohet si fluks parash ne te ardhmen per linjat e kredise. Disa parametra vleresimi te perdorura per llogaritje jane:

-Vlera e realizueshme e kolateraleve, e cila perllogaritet duke ulur vleren e kolateraleve te vleresuara me nje 'faktor skontimi'. Kjo e fundit merr ne konsiderate karakteristikat e grupeve te ngjashme te kolateraleve. Kjo nenkupton vleren mesatare te rikuperueshme te nje kolaterali te caktuar, i bazuar ne eksperiencen tone te procesit te rikuperimit te kolateraleve.

-Koha e flukseve te parashikuara te parase, e cila i referohet kohes se pritshme te rikuperimit (ne vite) te nje lloji te caktuar kolaterali.

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

### Risku i Kredise (vazhdim)

Kostot e rikuperimit zbriten nga fluksi i ardhshem i parashikuar i parase. Kolaterali pergjithesisht nuk mbahet per huate dhe paradheniet ndaj institucioneve financiare, perveç kur instrumentat financiare mbahen si pjese e marreveshjeve te ndersjellta dhe aktivitetit te huamarrjes nepermjet instrumentave financiare. Zakonisht, pengu nuk mbahet kundrejt instrumentave te investimit, dhe asnje peng i tille nuk eshte mbajtur ne 31 Dhjetor 2011 ose 2010. Parashikimet per vleren e drejte jane te bazuara ne vleren e kolateraleve te vleresuara ne momentin e marrjes se borxhit, dhe jane gjithashtu te rishikueshme cdo tre vjet. Nje perllogaritje e vleres se drejte te kolateraleve dhe instrumentave te tjere garantues, te mbajtur kundrejt aktiveve financiare tregohet me poshte:

| | Kolateralet per Huate dhe paradheniet klienteve 31 Dhjetor 2011 | | Kolateralet per Huate dhe paradheniet klienteve 31 Dhjetor 2010 | |
|---|---|---|---|---|
| **Per Individualisht te zhvleresuara** | **Bruto** | **Neto** | **Bruto** | **Neto** |
| Ndertesa | 22,898,844 | 13,329,717 | 13,793,146 | 7,682,097 |
| Kapitali | 131,036 | 37,391 | - | - |
| Mjete monetare | 151,382 | 143,130 | 145,422 | 142,029 |
| Pengje & Garanci | 4,625,958 | 1,767,280 | 3,469,172 | 1,298,535 |
| Te tjera | 255,177 | - | 445,116 | - |
| **Totali** | **28,062,397** | **15,277,518** | **17,852,856** | **9,122,661** |

Shuma bruto e kolateralit perfshin vleren e kolateralit perpara testimit te huadhenieve individualisht te zhvleresuara. Shuma neto tregon vleren e aktualizuar te te njejtit kolateral pas ketij testi. Tabela me poshte tregon totalin e kolateraleve per huadheniet e vleresuara ne kategorine e zhvleresimit kolektiv. Keto kolaterale nuk kalojne ne te njejten procedure testimi si grupi me siper, keshtu qe vetem vlera bruto eshte paraqitur.
Informacioni ne tabelen e meposhtme tregon se sa jane te siguruara huate dhe paradheniet e klienteve te zhvleresuara kolektivisht ndaj kolateralit perkates te tyre.

| | Kolaterale per Huate dhe paradheniet klienteve (Bruto) | |
|---|---|---|
| **Per Kolektivisht te zhvleresuara** | **31 Dhjetor 2011** | **31 Dhjetor 2010** |
| Ndertesa | 84,916,011 | 96,653,943 |
| Letra me vlere te borxhit | 5,212 | 4,609 |
| Kapitali | 1,298,042 | 1,325,008 |
| Mjete monetare | 3,179,641 | 3,721,803 |
| Pengje & Garanci | 17,352,530 | 18,845,933 |
| Te tjera | 1,129,865 | 2,003,071 |
| **Totali** | **107,881,301** | **122,554,367** |

# SHENIME SHOQERUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2011

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

## 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR ( VAZHDIM)

### Risku i Kredise (vazhdim)

Banka ka si politike qe te shese (te mos mbaje) aktivet qe mban nepermjet procesit te rikuperimit.
Vlerat qe mblidhen nga te ardhurat e shitjes se aktivit perdoren per te zvogeluar ose shlyer vleren e mbartur te huave me probleme.
Ne rastin e ndertesave si kolaterale ne pronesi te Bankes, konvertimi ne para eshte qellimi kryesor i Bankes, e cila ndermerr nje marketing te mirefillte per shitjen. Nese nuk ka asnje oferte te mire te mbledhur deri ne nje moment te caktuar, Banka ka si procedure te mbaje aktivin ne inventaret e saj per shitje deri sa te marre oferten me te mire.
Ne varesi te veprimtarise se Bankes dhe nevojave te saj dhe pershtatshmerise se aktivit per t'i plotesuar ato nevoja, menaxhimi vendos ta vere ne perdorim ate, rrjedhimisht behet nje riklasifikim ne aktivet operacionale te Bankes.
Natyra dhe vlerat perkatese te inventarit te kolateraleve me 31 Dhjetor 2011 paraqiten ne Shenimin 15.

Banka monitoron perqendrimet e riskut te kredise sipas sektoreve dhe vendit. Analiza e riskut te kredise ne daten e raportimit paraqitet si me poshte:

| | Hua dhe paradhenie klienteve | |
|---|---|---|
| | **31 Dhjetor 2011** | **31 Dhjetor 2010** |
| **Perqendrimi sipas sektoreve** | | |
| Pronat e patundshme | 1,304,919 | 1,431,547 |
| Prodhimi | 4,622,097 | 5,988,152 |
| Shitja me shumice | 11,893,141 | 11,589,403 |
| Ndertimi | 7,439,071 | 7,420,054 |
| Sherbimet | 12,290,647 | 9,144,063 |
| Te tjera | 1,875,588 | 1,574,533 |
| **Korporatat** | **39,425,463** | **37,147,752** |
| Kredi hipotekare | 6,640,060 | 6,583,279 |
| Konsumatore | 1,366,763 | 2,022,760 |
| **Individet** | **8,006,823** | **8,606,039** |
